

INTERVISTË ME VALDETE IDRIZIN

Prishtinë dhe Mitrovicë | Data: 14 dhe 28 maj, 2017
Kohëzgjatja: 167 minuta

Të pranishëm:

- Valdete Idrizi (E intervistuar)
- Erëmirë Krasniqi (Intervistuesja)
- Donjetë Berisha (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë te komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

[Pjesët në vijim janë realizuar në Prishtinë më 14 maj, 2017]

Pjesa e Parë

Erëmirë Krasniqi: Valdete, a mundesh m’u prezentu edhe me na, me na folë për fëmininë e hershme edhe çka t’kujtohet prej asaj kohe?

Valdete Idrizi: Une jom...

Erëmirë Krasniqi: Të gjitha. Familjen...

Valdete Idrizi: Po...

Erëmirë Krasniqi: ... rrethin, të gjitha tregona.

Valdete Idrizi: Unë jom Valdete Idrizi. Jom prej Mitrovicës. Kom pasë ni fëmijëri goxha aktive. Qysh... unë kam lindë, jam rritë në, në pjesën e veriut të Mitrovicës, n’qendër të qytetit në Veri, në një hapsirë domethonë t’përzime, etnikisht t’përzime. Jam çika e minatorit edhe kom qenë gjithherë krenare me, domethonë me këtë, thjeshtë, me këtë duke qenë çika e minatorit. Deshta, nashta ma mirë me thonë epitet sepse kur e mbanë me krenari, definitivisht, që domethonë e kom konsideru përnime si ni vlerë. Sepse jom rritë në atë frymë ku baba m’ka tregu për, jo veç punën, edhe tu folë për punën e, domethonë për miniera kom mësu thjeshtë mi dashtë edhe mi njoft bukuritë e venit tonë.

N’tjetrën anë, kur m’folke për solidaritetin n’vite t’ndryshme që minatorët gjithandej nëpër botë e kanë përkrahë tjetrin edhe sa jon t’lidhun, solidar. Ma vonë tani kur u rrita kjo veç edhe thjeshtë u konfirmu. E kjo definitivisht secilën herë m’ka bo mu ni shumë ma krenare pse jam prej Mitrovicës, sepse “Trepça” qysh e din gjithë, ka qenë e njoftun si njo prej gjiganteve kryesore në ish-Jugosllavi. Tani t’u qenë gjigant i madh kemi pasë thjeshtë mundësi me taku edhe njerz t’kulturave të ndryshme që kanë ardhë fillimisht me, me punu edhe me jetu. Ose kanë sjellë familjet ose kanë kultivu, kanë kriju familje te na.

Kështu që, jom rritë me një frymë ku ka qenë njëfarë fryme e diversitetit edhe thjeshtë qai diversitet u konsideru përnime si vlerë n’shoqni, n’qytet, n’shkollë, n’familje kur kemi diskutu. Fe të ndryshme, kultura të ndryshme. Kështu që, për ate menoj ky identiteti si mitrovicas gjithëhere m’ka bo me u ndi

jashtëzakonisht mirë sepse thjeshtë kemi, jemi adaptu shumë lehtë me kultura të ndryshme, qoftë edhe mrena Kosovës, domethonë qyteteve tjera ose kur kanë ardhë, ose.... Kështu që, shumë lehtë jemi mishëru, jemi përshtatë me ta.

Kështu që, shpeshherë bojmë hajgare thojmë kur edhe gjakovarët jonë ardhë në Mitrovicë edhe jonë ndi rahat si n'shpi t'vet, domethonë diçka paskemi edhe na se i kemi bo ata me u ndi mirë. Sepse ka pasë shumë profesorë, shumë profesionist t'lamive t'ndryshme që fillimisht kanë ardhë me punu edhe janë në Mitrovicë edhe janë shumë t'rspektum. Kështu që, jam rritë në një familje t'madhe. Tetë fmi kemi qenë. Po. Une jom fmiu i katërt. Domethonë, shoqërinë e kom pasë shumë t'mirë. Shkollën e kom pasë pesë minuta prej shko... prej shpisë, ose ndërtesës. N'katin e tretë kom jetu gjithëhere.

Shpesh n'pushim t'gjatë shkojsha n'shpi edhe e nijsha zilen edhe ngajsha me shku n'shkollë. Na shpesh kemi thonë nashta pasunia kur rritesh n'kallabllak osht' se domethonë edhe, edhe teatër, edhe sport, edhe çfarëdo lloj loje i kena pasë n'shpi, se gjithë kemi qenë ka dy vjet [ndërmjet], gjithë fmija. Kështu që, ne... e kujtoj me shumë, me shumë, me shumë nostalgji muj me thanë, po edhe me shumë dashni fëmijërinë teme. Ani pse kushtet ekonomike s'i kena pasë kurqysh.

Domethanë, m'është dashtë me pritë motrën deri sa t'ishohet p'i shkollë për m'i ja veshë jaknën se e kena pasë një jakne t'mirë për shkollë, s'e kena pasë dyjat ka një. Kishim qef me shku m'u duk mirë, sidomos n'shkollë t'mesme kur filloi pak m'u rritë. Mirëpo, kjo asnihere s'na ka bo me u ndi nashta ma pak i ransishëm apo pak ma ndryshe. Por, megjithatë, thjeshtë njifarë qasje praktike. Edhe jom shumë falenderuse ma s'pari për, për këtë, këtë atmosferë, këtë ngrohtësi që e kom pasë n'shpi prej dy prindve, prej vllazërve, motrave edhe familjes gjanë. Po edhe rrethin n'cilin jam, jam rritë, që, që kanë qenë qai rrethi në "te Berilet" jonë qujtë, në qytetin, në pjesën e Veriut të Mitrovicës.

Erëmira Krasniqi: A mundesh pak me na folë për familjen tonde të ngushtë? Për këtë, 'e madhe po e ngushtë'?

Valdete Idrizi: Po, i kam, qysh e thashë ma herët... përveç vëllaut vogël, fatkeqsisht ka, ka vdekë në fatkeqësi, domethonë e ka shkelë kerri kur ka qenë shumë i vogël, pesë vjet e gjysë... na tjerët, shtatë tjerët jemi gjallë. Disa janë në Gjermani, disa këtu. Motrën e madhe Vjollcën, tash jeton në Veri, ende, është kthy doethonë mas luftës. Bardhyli, tjetri vëlla, është në Gjermani. Dritoni, është vëllau me t'cilin matematikë ma s'shumti me te, se ai, ai ka qenë alfa-omega e matematikës edhe m'ka mësu edhe mu. Linda, motra jem dy vjet ma e vogël se une, tani Artoni edhe Burimi, dy vllaznit ma t'vogël. Njëri është në Gjermani, tjetri është në Mitrovicë.

Kjo është e mira kur e ki familjen e madhe se pamvarsisht nëse shkon dikush jashtë, megjithatë i kena.... Ende e kem një lidhje shumë-shumë t'fortë, sikur me, sikur kur kemi qenë, sikur kur kemi qenë t'vogël. E kena përkrahë njoni-tjetrin. Normal që kena edhe jena ngucë, e kena pasë asi e që u prishshim e u ndreqshim si çdo fmi tjetër. Por, përgjithsisht domethonë është nana diqysh si shtyllë e familjes, ajo që gjithë e kena pasë aty. Për ça do, mirë, keq e kemi pasë. Ani pse unë me, me babën kam qenë shumë, shumë e lidhun ngushtë.

Baba m'ka vdekë ende pa i mbushë 21 vjet une. N'kohën nashta kur ma, s'po di, nashta ma s'shumti kom konsideru që m'duhet. Ato e kom pasë shokun ma t'mirë n'jetë. Ai m'ka inkuraju ma s'shumti, edhe nana natyrisht, me qenë n'aktivitete tjera jashtë shkollës. Sepse une menjihere gjashtë vjet, si i kam bo gjashtë vjet kam shku në klasë t'parë pak ma herët se kom qenë fmi i gjallë. N'klasën e tretë

menjihere me aktivitete shtesë jashtë shkollës kom pasë fillu. Edhe asnjihere, domethonë jo me, jo me m'ndalë, po gjithëherë m'ka inkuraju me shku.

E di që fillimisht si fmi me ato kryqat, kryqin e kuq e mbajshim n'krahë edhe mbledhshim, mbledhshim t'holla për m'i ndihmu familjeve t'varfna. I çojshim n'kryq të kuq. Kuptohet që na, na, na jepshim domethonë udhëzime me u sjellë mirë, me qenë t'durushëm me njerzt n'rrugë, qasjen e mirë. E aty aftësitë, domethonë shkathtësitë e komunikimit veç i mson herët. Tani n'klubin e recituesve t'skollës. Kam qenë n'grupin e teatrit, që toni nja 17 vjet aktivisht jom marrë me teatër ma vonë. Edhe kom qenë, me shumë krenari, kom qenë Kësulkuqja e shkollës. Ndoshta që kom qenë pak rrumullake gjithherë, e vogël, e gjallë pak.

Eh, atëherë n'skollën tonë, shkolla "Hivzi Sylejmani" që thashë e kam pasë shumë afër, organizonin atëherë një herë n'vjet, domethonë organizojshin si, si këto paradat, domethonë gjitha shkollat ma kryesore në qytet. E zgjedhnin ka një përrallë edhe e improvizonin në një skenë, me një kamion shumë t'madh. Edhe shkolla jonë, domethonë, e ka zgjedhë Kësulkuqen. Unë kam qenë Kësulkuqja. Kom qenë edhe e nominume, e përkrahun p'i gjithve. Kur them gjithë, ajo shkollë ka qenë etnikisht e përzime edhe serb edhe shqiptar. Ani pse thonin që gara ka qenë goxha e madhe, po unë s'kom apliku, se e kom ditë. Arsimitarja e artit ka konsideru që une muj me qenë Kësulkuqe e mirë.

Edhe e kujtoj që kur u afrunë kamerat bash isha para banesës time, edhe nuk dijsa a me çu kokën nalt me pa nanën edhe babën. M'pytshin, "Si quhesh, a frigohesh prej ujkut?" E di që njihere gabova thashë, "Valdete Idrizi, huh, jo Kësulkuqja jom" (qeshë). Edhe nuk kam mrri me pa vetën kurrë n'televizor (qeshë). Se u pat' prishë televizori edhe s'patëm shancë domethonë me pa. Po, nuk ka lidhje, me randsi osht' që e kujtoj shumë atë skenë. Edhe nana po m'shohin po ndihen shumë krenar me mu. N'tjetrën anë ai turpi pak, si i fëmisë. Kështu që, kam qenë e angazhume gjithëhere në aktivitete të, edhe n'kuadër t'skollës, po edhe domethonë jashtë shkollës kurdo që ka pasë.

S'kom qenë njo prej atyne vajzave që lujshim nusesh prej banesës n'banesë, se kish edhe të atilla. Shkojsa kaniherë, po jo, nuse s'kom qenë asnihere, kështu që (qeshë). Noshta m'kanë bo, po s'më kujtohet, s'më, se konsideroj, se di... s'më kujtohet, nuk e kom regjistru. Po ka pasë aktivitete t'ndryshme, po gjithë kom dashtë me bo diçka, diçka ma ndryshe edhe gjithë m'kanë përkrahë n'shpi. Edhe këta jam, për këta jam jashzakonisht falenderuse. Se nuk do t'isha sot kjo që jam mos me pasë atë liri. Thjeshtë me bo diçka për një, thjeshtë me kontribu diçka për një t'mirë t'publikut, ose t'qytetit apo t'njerzve. E kjo m'ka, kjo gjithë m'ka bo m'u ndi mirë.

Edhe sot, noshta edhe në momente kur nuk jom mirë, ose... se secili njeri i ka ato momentet... gjithë dalë. Ka aktivitete sa t'dush me bo, edhe menjihere t'ngritet edhe morali edhe energjia. Edhe gjithë t'u, t'u marrë energji reflekton energji te tjetër. Kështu që, kështu jam rritë une. Me shumë, shumë dashuri e kujtoj atë pjesë.

Erëmira Krasniqi: Me qenë se krejt puna juj ka qenë për komunitet edhe në komunitet, edhe tregut që shoqniya ka qenë shumë multikulturore, edhe a kishit mujtë me na folë si ju keni pasë kontakt me krejt këta njerëz? Edhe në njifarë mënyrë je kujdesë për nevojat e tyne. A mundesh me na përshkru pak ma detajshëm këtë farë jete me njerëzit prej etnive t'ndryshme?

Valdete Idrizi: Nëse shkojmë domethonë krejt n'fëmini, domethonë ani pse qyteti ka qenë domethonë i përzim etnikisht, kur unë fillova m'u rritë, domethonë n'moshën e adoleshencës,

domethonë edhe ma e madhe, tani situata filloj mu përkeqesu menihere. E përmenda ma herët Greva e Minatorëve domethonë që i ngriti peshë t'gjithve, atëherë veç fillunë me u nda, domethonë komplet edhe aktivitetet, edhe rrugët. Edhe korzoja [shëtitorja] ka qenë ndryshe domethonë në Mitrovicë. Ka qenë nifar rregulle e pa shkrume, kah shkojnë shqiptart kah serbt.

E, ani pse domethonë me, me, me, me kojshi që i kishim, domethonë në ndërtesë, kurrfarë ndryshimi nuk ka pasë se jemi rritë aty, kemi, kemi shkëmby domethonë përshëndetje. Por, t'u u rritë veç filloi me, domethonë ajo njifarë lloj frike...

Erëmira Krasniqi: Prej krejtve?

Valdete Idrizi: Po, prej krejtve. Edhe nuk dishe ti faktikisht ka vjen, ani pse shumë konfuz, nuk dijsim çka, thjeshtë çka po ndodhë. N'tjetrën anë, kishim msu edhe në histori domethanë, na kanë tregu edhe pleqtë, edhe domethanë gjithë përpara që duhet me qenë pak t'kujdesshëm kur të... domethonë, ani pse lufta filloi në Kroaci, unë vëllaun e kisha atëherë në ushtri. Fatmirësisht u largu. Dezertoi edhe, edhe ka pasë shku në Gjermani. Po, fillum me ndi atë, atë frikën edhe fillum me qenë t'kujdesshëm, edhe kur në Kosovë nuk filloi qaq haptas.

Erëmira Krasniqi: Pse po... tash juve me siguri ju kujtohet edhe Greva e Minatorëve në '89-tën? A mundesh me na kallxu qysh, qysh ka qenë qyteti? A u ndi ai presioni i asaj çka ishte t'u ndodhë në "Trepçë", n'qytet, mrenda n'qytet? Qysh? Çkado që t'kujtohet?

Valdete Idrizi: Po, ka qenë, sidomos e maj n'men shumë mirë se, sepse baba jem ka qenë, ka pasë problem me shpinën, edhe ka qenë n'bahjë në Banjskë, ka qenë një banjë shumë e njoftun atje. Edhe, si filloi greva... pat' dalë n'pension t'përkohshëm, [jo] t'parakohshëm për shkak që ishte veç smut, ma vonë edhe ndroi jetë... po, e di që e la bajën edhe ka shku me, ka shku në Minierë. Edhe, edhe thjeshtë, domethonë me veprimet e tij edhe me ato qa na tha që "Osht' e domosdoshme o tash o kurrë". E dishim na që jon t'vendosun, diçka po ndodhë, edhe këta veç... domethonë situata veç s'po di nifar... për neve si t'ri ishte e paqartë çka, domethonë qa po vjen.

Mirëpo, n'tjetrën anë e kishim nifar force. Se kur thotë, domethonë, kur shkon baba, kur bohen gjithë bashkë, edhe me atë historinë ma herët që kishim, kishim dëgju ma përpara, shumë nifar besimi jashtëzakonisht t'madh. Po n'tjetrën anë, edhe n'shkollë kur shkojshim, edhe n'rrugë kur dilshim, se di, nifar, nifar qetësie. Qetësie negative, kështu n'qytet. Njifarë tensioni. Edhe, s'po di, njifarë pasigurie domethonë u kriju edhe, bile edhe aktivitetet pak nëse ishin diçka jashtë shkollës i reduktum pak. I bojshim mrena ose n'klasë, ose n'shpi disa.

Kështu që, veç, veç filloi me u ndi ajo, ai presioni. Tash, na nuk kishim, nuk ishim n'qatë moshë që m'i lexu krejt lajmet e m'i ditë komplet çka, qysh po ndodhë, veç e dijsim që na si shqiptar duhet m'u rujt tash. Edhe, domethonë shumë kujdes çka folshim, edhe tani edhe me serb tjerë. Edhe me njerz t'cilët i... n'klasë, n'klasën tjetër i kishe pasë, në t'njejtën shkollë. Filloi njifarë, ajo ndamja mes serbve edhe shqiptarve kryesisht. E kjo, tani më vonë, domethonë edhe, edhe n'shkollë, e thashë ma herët edhe n'korzo. Veç e dishe n'lokalet, kafiteritë që ishin, bash qaty ku kom jetu une plot ka pasë... muzika ka qenë, e kanë kultivu gati njejtë si serbt si shqiptarët. Muzikë shumë t'mirë domethonë krejtë mirë... po, nuk shkojshin nëpër lokale të, të njejtë.

Shqiptarët me një ven, serbët me një ven. Ani pse ka pasë përjashtime ndoshta në bazë të njerzve ose të njoftësisë, e di që kurrë s'kom shku në një, një kafiteri ku janë shku serbët se thjeshtë jom frigu, po kom shku aty ku, ku kom konsideru ma, që osht' ma lehtë. Sidomos na edhe në familje kena pasë njerz të përndjekun politikisht e domethonë i kemi ditë që nuk oshtë, që thjeshtë duhet m'u rujt prej, prej pushtetit të atëherëshëm. Edhe që, njëfarë frike që, s'po di e përzime me besim. Këna në fuqi nashta të minatorëve që me bo diçka ma mirë, në tjetër anë ajo, ajo frika edhe ndjenja e përgjithshme, ajo pasiguria për të ardhmen çka po ndodhë. Thjeshtë nuk, nuk e dishe. Kështu që, ajo kohë ka qenë një kohë me emocione shumë-shumë të përzime. Në tjetër anë jeta vazhdojke.

Erëmira Krasniqi: A ju ka tregu një baba juje prej episodave të protestës në Minierë? A dini diçka?

Valdete Idrizi: Po. E kujtoj shumë mirë kur ka dalë. Edhe prapë ka dalë me shpin kështu si i shtrengum, se nuk, nuk, se prej bajës... njëri ka qenë smut. E kujtoj se njëri ka qenë shumë si qokollatë {tregon me dorë fytyrën}, me pluhun e kështu krejt, domethonë njëfarë.... Edhe i thojshim "O babë, koke bo si qokolladë". Edhe tani thojke "Hajde pra..." Gjithë më thojke, se unë kom pasë qef aerokrem e qokolladë, e thojke, "Ani pra, ty ta kona, hajde me më uth" {e prek faqen}. E di që qashtu e kom uth. Edhe thashë, "Po".

Jo në detaje me na tregu gjithçka, veç, veç kur e pyta, "O babë, a ke mujt ti? Se je smut e je lodhë, e s'ke hongër." Ça i kishim pa lajmet. Thotë, "Jo, more" tha, "babë, a din sa ka ma shumë se unë atje? Unë veç një prej, veç një prej gjithë ata njerz që janë konë. Edhe kush neve, kur tregojsha"... Edhe u kthy pak mrapa. "Kurrë," tha, "nuk ndahen minatorët. Dhe nëntoka," thojke, "ka më lëvizë". Thojke, "Se na e dijmë, kjo osht' pasunia, kjo osht'...." S'po di njëfarë, megjithatë ta hup, njëfarë morali ta ngritë. Kurrë nuk e harroj çfarë ndjenje ma ka jep edhe që kanihere s'kishe nevojë më për sqarim tjetër.

Sikur, sikur e kuptojsha veç në shikim e tij pa, pa, nashta pa spjegu kurgjo ma tepër. Nashta edhe u frigojsha më pyt më tepër, më po ndodhë najsen edhe ma, edhe ma keq. Po prej tij çka ka reflektu, domethonë edhe ajo pjesa që.... "Ja ka vlejte", kështu e tha. "Po shumë bre babë, po ti s'ka lidhje edhe më pasë qenë. Tonë e kanë ditë që je smut". "Jo," tha, "unë kurrë s'kisha mujt pa qenë më ta". E kështu. E di që secien herë kur bohen, se nuk i du fort datat më, më i kujtu përkujtimet për atë, për atë.... Po edhe kur shkoj, se kam qenë edhe vet në minierë disa herë, kom qenë e kom lypë numrin e babës atje. Numrin 618 e ka pasë. Kom shku në horizontin e dhjetë, se thjeshtë dojsha veç më ditë.

Se e pytsha kur isha unë fmi gjithçka. "E qysh babë, e kështu? E a o ftoftë? A nxehtë?" M'tregojke, "Kah veriu o ftoftë". Na s'dishim atëherë kah o veriu. U kthejshim herë këndeje, herë andej. Kështu që, më ka, s'po di njëfarë... nashta besimi që domethonë kur bohemi bashkë munem më i lëvizë gjanat, edhe që nashta më më iu frigu të ardhmës, s'po di. Kjo ka qenë njëfarë, njëfarë force që e kom marrë për babës. Edhe pse përnime më ka bo gjithë më ndi që jom shumë, shumë krenare pse jom çika e tij. Sot, se e kanë njoftë shumë atë nëpër rajon të Shalës sidomos, se ka qenë edhe aktiv në Pajtim të Gjaqeve...

Erëmira Krasniqi: Hëm!

Valdete Idrizi: Po. Ai kish një, një, një pjesë tjetër, një histori tjetër që e kom, edhe po du më besu që e kom marrë prej tij, po larg jom prej...

Erëmira Krasniqi: Pajtimin e Gjaqeve të '90?

Valdete Idrizi: Po.

Erëmira Krasniqi: Me Anton Çettën?

Valdete Idrizi: Po.

Erëmira Krasniqi: O sa interesant.

Valdete Idrizi: Po, po. Ky ka qenë...

Erëmira Krasniqi: A mundesh me na tregu diçka? Qysh ka fillu ai?

Valdete Idrizi: Me te s'kom qenë asnjherë, fatkeqsisht, nëpër domethonë nëpër teren, po ky... se zakonisht në Minierën e Stantërgut në "Trepçë", zakonisht kanë punu njerzit e Shalës të Bajgorës, kryesisht, po ka pasë edhe tjerë t'ardhun...

Erëmira Krasniqi: Se ata e kanë bo thirrjen njihere...

Valdete Idrizi: Po.

Erëmira Krasniqi: ... prej protestës...

Valdete Idrizi: Po, absolutisht. E tani, duke qenë baba një kohë shumë t'gjatë, edhe ai, ai ka qenë një njeri që nuk ka pasë, nuk ka domethonë nuk ka kry shkollë, ka pasë katër vjet shkollë, për shkak kushteve ekonomike... mirëpo, nëse ti domethonë je ulë me te, edhe ka qenë delegat një kohë, nëse ti je ulë me bisedu me te me çfarë tema, ai ka qenë enciklopedi e gjallë. Sepse, e thashë ma herët, na kushtet ekonomike si kena pasë t'mira hiç, po libra ke pasë n'shpi ka je sillë.

Nashta këto, ormana s'kemi pasë ku mi lanë, mirëpo, se, domethonë osht' një njeri që ka qenë i interesum edhe ajo, kushtet ekonomike s'e kanë privu ate për me u zhvillu vetë edhe, edhe domethonë profesionalisht në fusha të ndryshme. Tani, i ka shku fjala gjithë. Sot e gëzoj një, një kredibilitet bile t'thom sinqerisht goxha m'rritet menja kur m'thojnë që i kom ga pak. Po vështirë osht' nëse, nëse i kom ga osht' një e dhejta jom si ai, une përnime nihna shumë, shumë, shumë krenare. Se po boj hajgare kur thom m'rritet menja, por definitivisht po. E tash, kur...

Erëmira Krasniqi: Ai e ka përdorë autoritetin e vet për me pajtu njerëz, a po?

Valdete Idrizi: Po.

Erëmira Krasniqi: Ka besu n'komunitet?

Valdete Idrizi: Edhe ka besu, shumë ka besu n'njerëz. I ka dashtë njerëzit shumë. Edhe kta e kom trashëgu se unë i du shumë njerëzit. Edhe pamvarsisht çka ka ndodhë, gjatë luftës kom pa që njerëzit kanë, janë tjetërsu, janë shëndrru n'bisha, mirëpo n't'njejtën kohë e kom pa anën tjetër që njerëzit kanë bo gjithçka për me shpëtu dikon tjetër. Edhe ai besimi në njerëzit s'më ka hup kurrë. E këto po mendoj e kom, e kom pasë edhe prej babës se kur thojke, "Eh, sot osht' një ditë shumë e mirë", kështu u kthejke n'shpi n'mramje.

“Hë babë?” “Ah, dy familje që janë konë me disa gjenerata që kanë pasë”, domethonë, “jone konë n’gjak, sot ja kanë shtre dorën njoni-tjetrit”. Kurrë s’ka thonë unë e kom bo. Hiç, hiç, hiç! Veç, “Ata janë pajtu”. “Babë, e qysh, e qysh?” “Po babë, duhet njerëzit, duhet mi lonë njerëzit me fol”. Edhe krejt, krejt, veç thojke me krijë qatë hapsirë që mos mu kqyr prej tjerve keq kur të, domethonë, kur shprehen lirshëm ata. Edhe thojke, “Kur të, kur ja zgatin, kur ja jepin besën njoni-tjetrit s’ka aty kthim mrapa”.

Edhe kur vike kështu, kur thojke, “Sot osht’ një ditë e mirë”, e dishim që diçka, domethonë e ka, u konë naj rast që... Ma vonë unë e kom marrë vesh, tek ma vonë domethonë që ka qenë ky bajagi i randsishëm n’këto procese. A, te na veç ka thonë kom qenë aty pjesë me krejt. Edhe fokusin e ka pasë te ata që janë pajtu, jo te ndërmjësit kush kanë qenë. Sepse Anton Çetta që ka qenë domethonë njëfarë idhulli i tonve neve, sidomos nashta neve që kena ditë pak ma shumë për punën e tij... po domethonë baba veç ka thonë, “Proces i pajtimit...” na e dishim që, personalitetin, figurën e profesorit Çetta, po sa kanë qenë t’randsishëm këta ndërmjësit lokal. Po. Tek ma vonë thashë e kom, e kom, e kom kuptu sa me t’vërtetë i randsishëm ka qenë edhe, edhe baba.

Edhe sot kur shkoj kur m’thojnë, “Dihet e kujna je ti edhe prej kah e ke trashëgu”. Kështu që, jom, domethonë këtë kohë edhe për Minierë, edhe n’atë kohën sa, të ‘90-tave, domethonë deri kur filloi edhe te na krejt me u, thjeshtë me dalë në sipërfaqe gjithë ai presion që e kena, që e kena vuajt. Ose, kanihere kur metsha mas aktiviteteve t’shkollës shkojshim në komunë t’qytetit. Edhe atëherë tani situata u përkeqësua, edhe çertifikatat e lindjes apo çfarëdo lloj dokumenti, qito ekstraktet e lindjes që dojshin njerëzit m’i nxjerrë në komunë edhe i keqtrajtojshin. Sidomos njerëzit që vinin prej, prej katuneve sepse s’dishin çirilicë me plotësu, ose i lypshin dy-tre fish pare që s’kishin ose kështu.

E na t’u qenë, une me disa shoqe t’mija t’u qenë, domethonë jemi rritë në qytet në zonë urbane, dishim edhe çirilicën edhe domethonë serbisht. Edhe u mshefshin te një ka qenë aty një, një shtyllë mrena komunës, m’kujtohet edhe tash kur hyj, u mshefshim mos me na pa gjithë t’njejt, edhe jau plotësojshim formularët. E kaniherë kur u vonojsha, nana na qortojke. Edhe thojke, “Qysh që sa s’je ardhë e as s’ke hongër bukë. E për detyra?”. Domethonë s’pi bon detyrat, ose me nimu n’shpi se shumë fmi edhe si çikë mi nimu diçka. Edhe si i kallxojsha po kështu, kështu, kështu. Baba m’dilke n’krahë mandej thojke, edhe e di që e përqaftke nanën thojke, “Le se dikujna kjo... për qef nuk rrin kërkush n’komunë”.

A din? Diqysh ma ka jep njëfarë besimi që une edhe që jom vonu, edhe nashta që kom harru qatë ditë detyrat, e din që i kom zavendësu noshta me një akt tjetër t’mirë. Këto, kjo ka ndodhë jo një herë, po shumë, shumë herë. Ndodhke veç pak me pasë kohë t’lirë vishim knena në Jug te komuna tash, domethonë ku ka qenë gjithë edhe tash osht’. Edhe n’atë mënyrë kemi qenë tani dëshmitar të sjelljeve t’kqija, t’u i shty, t’u i sha...

Pjesa e Dytë

Erëmira Krasniqi: Qysh ndroi jeta ‘90-tave?

Valdete Idri: Po tash...

Erëmira Krasniqi: Qysh ishte shkolla e mesme, a po na tregon diçka?

Valdete Idrizi: Po. Na noshta, noshta një diç, një, s'po di si familje e kena përjetu secilën, secilën rrymë a stuhi që na ka ndodhë neve, domethonë shqiptarve, diskriminim. E kena përjetu drejtë n'familje. Qysh e thashë ma herët, fillimisht edhe lufta në Kroaci, e kom pasë vëllaun atje që s'kemi ditë një kohë shumë t'gjatë çka po ndodhë deri sa ma n'fund doli. Faktikisht erdh nihere këtu si me njëfarë llotarije që i lshun këtu domethonë me ardhë n'pushim. Po, kur ka tregu ai edhe qysh kish, ish transformu djali n'krejt diçka tjetër, ai Dritoni që është dy vjet ma i madh se unë, i ri.

Tani ka shku me një dokument, domethonë t'fallsifikum të, të burrit çikës tezës, domethonë të familjarit, ka rreziku edhe ka shku në Gjermani. Tani veç e pat', informatë t'dorës t'parë veç e patëm marrë noshta që ç'a osht' ka ndodhë atje. Tani ma vonë fillunë helmimet n'shkollë. Eh, Linda, motra jem ka qenë një pi rasteve ma t'rana në Mitrovicë.

Erëmira Krasniqi: U helmu?

Valdete Idrizi: Po. Edhe sa herë ka ndodhë n'shpi që thjeshtë veç është alivanosë. Për shembull, ka qenë në, ka qenë t'u bo dush edhe dera mbyllë, veç e kena pa ujin t'u shku, domethonë t'u shku t'u mos u nal edhe osht' dashtë me e thy derën. Edhe ajo e pa, domethonë e alivanosun.

Erëmira Krasniqi: Pa vetëdije?

Valdete Idrizi: Pa vetëdije hiç. Hiç!

Erëmira Krasniqi: Çka i ka ndodhë asaj? Ka shku n'shkollë...

Valdete Idrizi: Po ka shku n'shkollë, si gjithë tjerët. Edhe po si duket varet pej, dikush kush ka qenë ma shumë imun domethonë nuk e ka, nuk e ka...

Erëmira Krasniqi: Absorbu?

Valdete Idrizi: Po, nuk ka ndiku qaq shumë domethonë. Ndoshta një trullosje. Se edhe në, në, në klasën time kanë qenë tri vajza që janë helmu n'klasë, po na, na tjerët jo. Atëherë motra varsisht n'atë, në, në... se me ndrrime kemi qenë njena paradite tjetra masdite, ajo ka qenë n'vitin e parë une n'tretin m'duket, po, ose n'dytin t'katërtin, kështu saktësisht m'u kanë përzi po n'shkollë t'mesme, n'gjimnaz, t'njetën ndërtesë. Edhe veç kur e kanë sjellë, na e njëjtëm n'lajme, kur e kanë sjellë me domethonë për krahi një prej arsimtarve me dy-tre nxansa, që Linda osht' helmu, tani veç n'lajme ajo.

Nuk dishim as qysh mu sillë me te. Veç njëfarë si ngërç e kapke, u shtrengojke. Edhe e di që na thojshin, gjyshja na thojke me marrë me gjylponë se po e, gjuhën po e kafshon. Qito ishin ato qysh u manifestojke kur e, kur ndikojke. Edhe nuk e dishe kur p'e kap ai sulm. Edhe njihere, na n'tretin kat kemi banu, ka qenë n'dritare t'u pa diçka poshtë edhe veç {tregon me duar si e varur në dritare} ka mbetë kështu. Aty, veç a din, s'po di, fatin e ka pasë dikush ka hypë prej familjes edhe e ka, ja ka ngjitë për kome se ka mujt me shku.

Erëmira Krasniqi: Sa i ka zgjatë kjo?

Valdete Idrizi: Goxha shumë i ka zgjatë kjo. Linda plotësisht osht' shëru kur ka shku në Gjermani. Ka shku në Gjermani me t'fejumin e vet edhe osht' martu shpejtë sa m'i rregullu dokumentat me shku bashkë. Edhe, se deri atëherë kjo, nuk e kemi ditë... edhe nuse kur ka shku, jo asi, s'ka pasë asi neja t'mdhaja po shumë modeste, veç t'familjes...

[Shkëputet biseda]

Erëmira Krasniqi: Për shembull në Gjermani, plotësisht u shëru?

Valdete Idrizi: Po, u shëru në Gjermani plotësisht, sepse thjeshtë u pa që osht' e domosdoshme me shku dikah. E di që ka pasë shku disa herë te një kishë në Binqë dikah. E kanë pasë, i ka pasë dhonë disa inekcione qetësues, disa mjek t'huj patën ardhë, mirëpo...

Erëmira Krasniqi: E diagnoza, domethonë a ja patën jep për helmime?

Valdete Idrizi: Hiç nuk e di, kjo ka mbetë njëfarë enigme noshta. S'paku une nuk e di noshta. Profesionistat e di që kanë disa lloj interpretime po nuk e di hiç. Asifareë gazi që përdoret ku me ditë... a po beson tash kur i pamë në Siri kohëve t'fundit, thjeshtë të kujtohet ato rastet... po ku me ditë çfarë gazi ka qenë ai. Por, ka qenë edhe ajo frika që këta që jonë t'helmum s'kanë me lindë kurrë. E motra ka qenë shumë... kjo ka pasë ndiku edhe në, edhe në te. Tash është nanë e tre fmise. Por, kjo e pat' fatin edhe shkoj në Gjermani. Edhe në Gjermani tani e kanë, e kanë kërku n'ato listat që i kanë pasë "Mjekët pa Kufi" a ku ta di une, komuniteti ndërkombëtar, edhe e kanë gjetë në listë, tani e kanë trajtu pa as, domethonë pa pagesë. Nja një vjet e di që ka pasë trajtim. Ani pse...

Erëmira Krasniqi: Ka qenë propaganda shumë e fortë që ajo s'ka qenë helmim, n'fakt s'i kanë helmu hiç. A gjejshit mirëkuptim n'qatë kohë kur ajo kish kriza për me, n'fakt veç me thonë që ajo është e helmume? A e din, a ka qenë problem me thonë që je e helmume, meqenëse publikisht o thonë që osht' histeri kolektive?

Valdete Idrizi: Ndërtesën ku kena jetu na ka qenë pesë katshe. Na n'tretin. Edhe ka qenë me numër t'familjeve serb kanë qenë ma shumë, po me numër t'banorve, se na familje t'mdhaja, kemi qenë na shqiptartë ma shumë. Sa herë e sjellshin, se ka ndodhë ka tri herë n'javë e sjellshin prej shkolle...

Erëmira Krasniqi: Me sulme?

Valdete Idrizi: Me sulme, pa vetëdije edhe krejt kojshia e shihshin. Edhe asnjë koment. Hiç! N'fillim noshta, "A, šta je bilo?" "Çka u ba?" Edhe nana s'ka dashtë kurrë me fol serbisht, thojke, "Qysh çka u ba? E kanë helmu. E ka helmu Beogradi" thojke. Edhe as nuk komentojshin hiç. Se na njëfishin se qaty kemi jetu gjithë. Kjo diqysh ka qenë njëfarë lloj, deklarativisht s'pe pranoj. Po s'ki, s'ke mujt me e shmang këtë t'vërtetën. Sepse një, noshta një simptomë tjetër është se kur vijshin shoqniya, tash vike n'shpi vishin t'klasës me e pa, tani si e shihshin njona-tjetrën, se dy-tri na ndodhke... na ka ndodhë njihere tri përnjihere janë, i ka rrok sulmi edhe s'dishim çka me bo. Mule me thirrë domethonë ambullantën edhe...

Një periudhë jashtëzakonisht e ranë. Kështu që, këto kanë qenë që e, qysh e thashë si familje kemi qenë diqysh t'përjetum direkt prej, prej gjithçkafit. Edhe tani, kurgjo nuk ka ardhë mo si befasi këto ça ndodhi domethonë. Na përjashtun prej shkollës. Une diplomën e shkollës t'mesme n'kafe t'çajave jom

shku e kom marrë, sepse s'kom mujt mo n'gjimnaz me shku se i largun gjithë domethonë prej, prej shkollës. Une e kom pasë fatin mos me shku n'këto n'shkolla private, po menoj n'fakultet po, por tani në shkollë t'mesme hera, hera fundit domethonë kur kom shku n'shkollë, mrena n'objekt, ka qenë para përfundimit të vitit t'katërt. Veç që thashë diplomën aty afër shkollës disa kafe, shkojshim.

E kjo veç filloi domethonë me u ndi jashtëzakonisht shumë. Plus kam qenë edhe n'gjimnaz shumë aktive në aktivitete edhe atëhere. Tani ma vonë edhe organizojshim ligjerata t'ndryshme, profesorë t'ndryshëm. E di që profesor Esat Stavileci ka ardhë sa herë. Diqysh na, na ngritke edhe moralin gjithve. Njifarë besimi, njifarë.... Edhe, kështu që kur goditesh ose kur përjeton gjithëhere prej, prej qatij regjimi tani veç nuk ki lluks tjetër për m'u dorëzu ose veç me pa, po veç duhet me bo diçka, me u angazhu, me.... E unë e kom pasë qat' shtytje qysh e thashë ma herët, qat' mirëkuptim edhe prej familjes.

E tani une, plus e patëm na një përjetim tjetër edhe ma t'ranë se tani na vdiq edhe baba n'moshë shumë t'hershme. Shumë, shumë. Baba ka ndrru jetë në '95-tën. '93-tën vëllau domethonë. Edhe në '94-tën daja i cili rrike gati te na, 29 vjeç. Kështu që, kena pasë tragjedi mas tragjedi në shpi. Edhe, mirëpo ajo humbja e babës ka qenë kulmi i të, i të gjithave. E kështu që, s'po di, duke qenë aktive noshta, edhe aty e disponushme për tjerët, n'këtë formë e kom fuqizu vetën pa ditë. Pa e ditë.

Erëmira Krasniqi: Me përballu ma lehtë?

Valdete Idrizi: E me i përballu tani krejt sfidat qa na kanë pritë në '99-tën. Neve në '98-tën, se e kisha edhe vëllaun tani ushtar që shkoi shumë i ri. Tani, dy vllaznit ku shitshin cigare, kikirika, vishin policija.... Sa herë na kanë ardhë n'shtatë mëngjesit edhe i kanë rreh e jau kanë marrë qato paret. "Pse po shitë, ilegalisht pse po shitni". Nana i pjeke kikirikat, që për me shku na n'shkollë. Kështu që, ka qenë periudhë shumë, shumë e vështirë. Me, thjeshtë me mbijetu. Edhe tani kur të, kur të, kur te përjeton shumë afër atë, atë grusht, atëherë tani përgatitesh për gjithçka, për ma t'keqen. Përgatitesh me mbijetu edhe me bo ma t'mirën t'mundshme që ti ke, që me ka... thjeshtë me kalu noshta ma, ma lehtë apo ma mirë.

Erëmira Krasniqi: A shkutë në, a shkutë n'fakultet manej në Prishtinë a qysh?

Valdete Idrizi: Jo, jo.

Erëmira Krasniqi: Çka bonet në '90-tat?

Valdete Idrizi: Në domethonë në fakultet kom shku në fakultetin Xehtaro-Metalurgjik në Mitrovicë. S'ka qenë domethonë zgjedhja jeme sepse une kom dashtë aktrimin gjithë me shku. Ose po, ose sociologji, psikologji, sepse t'u shku ndërkohë kur... kom qenë shumë aktive n'teatër... edhe...

Erëmira Krasniqi: Tregona pak këtë pjesë Valdete nëse mundesh?

Valdete Idrizi: Po, fillimisht në Teatrin "Aleksandër Moisiu" në qytet. Edhe tash, për me dashtë me realizu ni rol shumë t'mirë, edhe lexojsha shumë psikologji pse ky karakter sillet ashtu, pse ashtu, me qenë domethonë me, me realizu sa ma mirë karakterin. E, lexojsha tani vepra të ndryshme në atë kohë. Edhe, edhe kom qenë aktore goxha e mirë (qeshë). Se i fitojsha çmimin e publikut...

Erëmirë Krasniqi: Super.

Valdete Idrizi:... e menoj që publiku është... a nashta karakteret kanë qenë t'tilla që më kanë ekspozu pak ma shumë. Por, kom dashtë me studju domethonë aktrimin, po kushtet ekonomike s'na kanë... . Shancë nuk ki pasë ti me, domethonë me shku në Prishtinë me pagu, ose rrugën, autobus. Ne s'kishim me shku. E tani, në tjetrën anë nuk kom dashtë me nejt në shpi. Edhe, ça kom pasë tani a me shku teknologji, a metalurgji a? Gjeologjija ka qenë ni pjesë nashta që m'ka nxitë, masi babën minator. Kom thonë, "Okej, po shkoj n'gjeologji". Nuk kom qenë njo prej studenteve ma t'mira se kur shkojsh diçka me zor, hajt. Po, kom qenë njo prej studenteve ma aktive që ka pasë fakulteti Xehtaro-Metalurgjik, sepse a organizojshim brucoshiada, a absolventiada a, këto vitet e, domethonë, ditëlindja e Hasan Prishtinës, të veprimtarve t'ndryshëm....Une e kom, kom qenë njo prej organizatoreve.

Kështu që, kom moderu, gjithëherë kom qenë në aty, mirëpo edhe domethonë në organizim në protesta të ndryshme që jonë organizu të, të studentëve. Edhe paralelisht isha tani edhe në këtë teatrin eksperimental "Show Meselation", kom qenë njona prej bashkë-themeluseve të teatrit, sepse lujsim bashkë me Blerimin e Fehmiun edhe tjerët. E ky ke pak ma ndryshe edhe na qujshin jo-serioz. Po veç thjeshtë mision e kena pasë për qatë kohë sa jonë njerëzit që na shohin rreth një orë me pasë një buzëqeshje n'fityrë.

Edhe, diqysh kjo ka qenë misioni jonë edhe mu m'ka, m'ka ndihmu shumë n'jetë me ju qasë domethonë n'momentet ma t'vështira t'jetës. Përvoja në teatër, përvoja edhe ne gjeologji në fakultet me kolegë t'ndryshëm, me gjenerata t'ndryshme m'kanë nimu edhe punën tani ma vonë, mas luftës thjeshtë me ju qasë ma lehtë edhe problemeve. Besa edhe gjatë luftës me ju qasë domethonë jetës, ose mbijetu, për me mbijetu. Thjeshtë m'ka, m'ka ndihmu shumë.

Erëmira Krasniqi: E përmende organizimin e protestave të '97-tës. A po na tregon qysh, po menoj qysh i ke, me çfarë arsye? A keni pasë bashkëpunim me Prishtinë?

Valdete Idrizi: Po.

Erëmira Krasniqi: Apo për, çfarë ideje ka qarkullu kur jeni çu në protestë?

Valdete Idrizi: Ajo u konë shumë thjeshtë për me u shliku Kosova se e dishim që n'institucione mo nuk ka. Edhe para protestës, para se me i pri domethonë protestave na e përjetojshim si studenta kur kanë hy policija edhe i rrehshin krejt kolegët mashkuj. I kanë rreh në, në... edhe profesorin, njo prej profesorëve domethonë, Skender Hotin, profesorin e gjuhës angleze, e kanë pasë, ja kanë pasë thy dhomtë n'prezencën tonë. Edhe neve domethonë vajzave na lshojshin. Bile njeni që ka qenë në Veri thojke, "Ani ti, babën n'spital," tha, "e këtu po, po vjen. Kishe po... Me çfarë literature?" Na thojshin, "Me literaturë të Shqipërisë po mësoni". Me pretekste të ndryshme veç sa mos me t'leju ty domethonë me, thjeshtë me shku studente se konsideroheshim t'rrezikshëm.

Kështu që, une sa herë kom majt, i kom majt domethonë skripta, se libra vështirë e kena pasë për me, për gjeologji me gjetë n'gjuhë shqipe, kroatisht i gjejshim... por kom plot skripta që i fotokopjojshim se ma lirë kushtojshin... edhe i majshim n'çantë. E, gjithë i kom majt edhe këto trenerkat, patikat se thojsh po shkoj edhe, veç n'teatër. Krejt thojshin kjo osht' aktorja, e me thonë studente vike pak ma.... Se u, domethonë u përkeqësu.

Tani, u takojshim këto takimet n'shköllë që duhet me, domethonë me bo diçka. Edhe kur filloi, kur fillunë domethonë Albin Kurti me të tjerët domethonë në, në Prishtinë, tani secilat fakultete jonë organizu, domethonë këshillet organizative. Edhe i kemi, domethonë i kena përkrahë, secili n'qytet t'vetin. Ato shetitjet mbramjeve dilshim, tani ato me, me kmisha, bluza t'bardha që dilshim n'qytet. Pastaj këto protestat e grave me atë letrën e bardhë përpara domethonë që u organizojshin. Nuk ka pasë protestë thjeshtë, që osht' inicu prej dikujt që s'kemi krejt, domethonë diqysh...

Erëmira Krasniqi: T'përfshimë.

Valdete Idrizi:... t'përfshimë. Sidomos na në Veri e kena pasë pak ma t'vështirë se kur dilshe ti me këto, me letër, tash krejt t'shihshin. Ti u ekspozojsh. E dishin çka po, po... nuk, thjeshtë nuk na kanë ndalu. Kështu që, edhe protestat e studentëve është dashtë shumë herë me i udhëheq me i kamufllu domethonë edhe ligjëratat. Paramendo, ato ishin gilinderat e lartë dy metra edhe u dashke me shku lartë për me ikë arave... sepse na shkojshim, kur i majshim ligjëratat shkojshim me ata t'klasës parë se fakulteti Xehtar-Metalurgjik në shkollën "Skënderbeu" domethonë kena viju. Paramendo shkojshim njejtë hishim me ata n'klasën e parë.

E, tani ajo shkollë ka qenë në, në rruga Varjanicës ka qenë në hyrje të Mitrovicës një shkollë kah t'vishe prej Prishtinës, po jo n'qytet. Po nja dy kilometra gjithë kom ecë për me shku atje. E tani kur vishin kështu policija u deshke... me qëllu në dytin kat? Shumë kemi hek tani m'i gjetë ato kthinat edhe me, me, me kalu. I patën çelë masnej disa, veç na e dishim qysh për me ikë që kush nuk mujke me dy metra me, me kalu. Kështu që përjetimet t'njipasnjishme kanë qenë. Ai, ai presioni edhe sulmet që vishin nga ushtria u shpeshtun. Nuk, s'kanë qenë mo...

Erëmira Krasniqi: Qysh kanë qenë raportet me kojshitë e ju, po menoj që ishin t'nacionaliteteve tjera? A ishin pasiv karshi krejt qëtyne seneve? A kontribojshin me naj koment?

Valdete Idrizi: Ata direkt, direkt na kojshi që i kemi pasë nuk kanë kontribu, mirëpo njifarë lloj marrëveshje n'heshtje, e pashkrume, që na s'po folim ça o t'u ndodhë, na nuk dijmë. Edhe ti, domethonë ani pse e dijshe, ani pse unë i thojsha po shkoj në, po shkoj në teatër. "Ku po shkon kojshike?" Thojsha, "Po shkoj në teatër." N'teatër bash n'mëngjes nuk shkon kërkush. E dike që jom t'u shku n'ligjërata po disa gjana nuk bojke me u thanë. Kështu që, sikur e dijsim por nuk folshim. Për kurgjo nuk folshim për situatën, absolutisht hiç, hiç, hiç.

Ka qenë njifarë shkëputje totale. Po ma vonë i kemi pasë disa policë që vishin, erdhën n'banesë tonë jetojshin. E prej tyne u deshke me u frigu shumë. Ai ka qenë njo prej atyne që ka pasë ardhë disa herë n'mëngjes te na për me, dy vllaznit e mi për me i, ma jau marrë domethonë.... Se edhe tani, domethonë ose pse e ke rreh ate, ose pse e ko bo këte. Kështu që, uh sa zhurmën. Na ka ndodhë disa herë me na ardhë n'mëngjes shumë herët. Edhe s'kishe ça me bo, veç u dufke me plasë edhe, edhe veç me lutë ose me mbrojtë me trup se t'ri, ma t'ri se une.

Edhe i marrshin qato, qat' pazar që e kanë pasë ditën. I gjujshin kikirikat, sa herë ja kanë gjujt nëpër tokë n'banesë. E, kështu që nuk... gradualisht jonë, osht' bo, osht' keqësu, keq e ma keq.

Erëmira Krasniqi: Ishin lokal ata apo i kishin pru prej Serbisë? Edhe çka...?

Valdete Idrizi: T'përzime ka pasë, edhe lokal. Për shembull, njëri prej atyne policëve ka qenë, nuk ka qenë gjithëherë, s'ka jetu këtu n'banesë tonë po ish me një, me një gru aty domethonë edhe vike shpesh. Ratko e ka pasë emnin. Ai ka qenë një famëkeq kështu ju frigojshin krejt, e na e kishim një kat ma nalt n'banesë. Po kjo ka qenë domethonë njëfarë, njëfarë situatë. Po n'tjetrën anë jom konë shumë fatlume sepse krejt këtë, krahas kësaj, kësaj jete shumë t'ranë, t'u qenë shqiptar e kom pasë këtë jetën tjetër t'pasun që s'më ka leju me domethonë veç me u, me u preokupu, a po m'u ballafaqu veç me këtë frikën, apo me këtë pasiguri.

Po, me këto angazhimet shtesë domethanë, sepse kena dhonë tani shfaqje gjithandej në Kosovë, edhe kjo diqysh t'majke edhe diqysh ta ngritke moralin, t'jepke energji, pozitivitetin ta jepke. Domethonë, me dashtë jetën pamvarsisht që ndodhë njëfarë, e krijojke njëfarë balanci. Edhe përnime jam shumë fatlume edhe...

Erëmira Krasniqi: E çfarë shfaqje keni bo? Po menoj a ishin, ishin komike, me tone politike a qysh? A ishin?

Valdete Idrizi: Ka pasë të ndryshme. Për shembull, me, me këtë, me "Show Meselation" kanë qenë domethonë tragji-komedi, humor i zi ma shumë. Për shembull, ka qenë rubrika "Ça po flitet?". Gjithëherë ça u flitke në Kosovë i folshim edhe këtu gjanat e kqija po n'atë mënyrën, domethanë komike. Apo gjeneratave, e trajtojshim edhe atë çështjen e migrimit atëherë që shkojshin njerëzit, që mos me shku po duhet me nejt edhe me bo diçka për këtë ven. Edhe çkado që ndodhke, aktualitetin faktikisht e qitshim në skenë. Po gjithëherë me karaktere, personazhe që, shumë komike që publiku përnime i dojke shumë.

E me këtë teatrin tjetër, se paralelisht luajshim n'dy teatro, me teatrin domethonë "Aleksandër Moisiu" për shembull kemi pasë edhe komedi, kemi pasë tragji-komedinë, "N'shkofsha mos u kthefsha". Ate, edhe në "Medresen" në Prishtinë e patëm, e patëm dhanë atë shfaqje se thjeshtë dojshim te një, për me depërtu te njerëzit sa ma, sa ma shumë njerëz që mos me shku, mos me, mos me lshu Kosovën. Se atëherë shkojshin numër shumë t'madh. Kanë qenë disa me karakter domethonë, domethonë përnime atdhetar "Kërsimë është emri im". U dashke me i mshef rekuizitat ato armtë, ato, ato veshjet kombëtare që u veshshim na.

Domethonë gjithë njëfarë kamuflazhe u deshke, u deshke me u pregaditë ai plani B kur hishin rrugës policia. A shkojshim për Istog, a për Pejë, a Prishtinë, ishin ato ndalesat. "Ku po shkoni, tek po shkoni?" U deshke me ju thonë, kurrë s'e harroj me Miki Mausin ju thojshim, "Kena shfaqje me Miki Mausin". Sepse s'guxojshim mi tregu t'gjitha. Po ka qenë një, një laramani, domethonë aktiviteti ish i shfaqjes po krejt e kanë pasë atë qëllim që thjeshtë n'atëfarë katrahure, n'atëfarë kohe që qatyne njerëzve s'paku një buzë....

Qat' një orë njëfarë lloj relaksimi, edhe njëfarë, s'po di, nashta njëfarë energjie t'mirë. Se shumë vështirë u konë. E osht' mirë dikur... dikur besa kur ja nisshim me dhonë shfaqje edhe n'disa prej lokaleve ja nisëm edhe me fitu kapak. Tani, t'u fitu mujshe m'i nimu dikuj tjetër edhe ndryshe. Kështu që, ose për shembull une fillojsha me qato pare me, me pagu semestrin. Se ka ndodhë që e kom hup edhe vitin se s'kom pasë pare me pagu për shembull. Po s'e kom pasë atë problem me qenë kurrë ma e mira. Kurrë s'kom qenë ma e mira. Kështu që, me randësi (qeshë) osht' me, me randësi me ecë. Edhe, nuk e di, kështu kom metë tani aktive tonë jetën, deri kur, kur u keqësu shumë situata.

Erëmira Krasniqi: Qysh e kalutë luftën Valdete? Në Mitrovicë manej?

Valdete Idrizi: Uh, kjo është një periudhë tjetër shumë, shume e ranë. Na veç vllaun prej '98-tën pat' shku me qenë ushtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Edhe une nuk e përkrahi hiç n'fillim. Nuk e përkraha se shumë i ri, domethonë hala 18 s'i kish bo edhe thojsha ky s'ka me ditë m'u rujt.

Erëmira Krasniqi: Kush e rekrutoi vëllaun?

Valdete Idrizi: Vetë ka shku sepse tha, "Me ardh apert Ratko me m'rreh mu këtu gjithë a?" Se ai tjetri vëlla në '97-tën shkoi. Edhe nuk ka dashtë me shku kurrë po e pamë që po keqësohet edhe mosha e tij ke shumë delikate. N'atë kohë t'fshijshin, a din? Edhe si me zor diqysh menxi. I çunë këta vëllaznit tjerë do pare. Me lidhje qishtu diqysh në t'zezë që shkojshin nëpër male, nëpër Hungari, ku ta di unë. Edhe, tani veç Burimi, unë edhe nana patëm metë n'shpi. Burimi osht' gjashtë vjet ma i, ma i vogël se une. Edhe kur tha shkoi. Edhe kur, edhe gjithë ma përmën sot kur i kom thonë, "Ani me bo me m'myt [jo], me bo me dekë pa t'myt se lo" (qeshin). Se t'u u tut se s'din m'u rujt se shumë i ri.

Edhe, e kështu që edhe ky shkoi. Edhe Burimi shkoi. Edhe tani, edhe përnime ma vonë, jo ma vonë, po e kom arsytu sepse kush munet me nejt n'shpi kur vjen, edhe veç për pikë t'qefit t'vjen dikush n'mëngjes ose kështu, t'maltreton në sy nanës, motrës. E na veç diqysh e përjetum ma herët. E tani edhe ajo ka qenë ajo kohë shumë sfidë sepse thjeshtë u frigojshim prej policëve, se n'qytet shumë pak ka pasë që kanë shku. Prej fshatrave pak ma lehtë u konë me u rujt, kushtimisht po e thom. Edhe tani, edhe osht' plagosë tri herë. Edhe e kom trajtu vetë gjatë luftës, kështu që kom bo praksë n'te.

Erëmira Krasniqi: Qysh komunikojshit ju me to? Ndërkohë, çfarë komunikimi kishit derisa ishte në UÇK?

Valdete Idrizi: N'telefon normal se s'ka [pasë], nuk mund, se s'kena pasë. E kena pasë veç një fiks, një telefon n'shpi. Edhe ka qenë një autobus që shkojke prej te tregu në Mitrovicë deri në Bare, fshatin Bare në Shalë.

Erëmira Krasniqi: N'cilën zonë ka luftu?

Valdete Idrizi: Shalës. Ka qenë "141 Mehë Uka", brigada në Shalë të Bajgorës. E une atje kom shku tri herë n'javë me qat' autobus. Po secilën herë që kom hyp, gjithë a din u konë ajo tuta çka m'i thonë që m'nalin policija, ku po shkon, se ku po shkon dej atje n'fshat. Kështu që, kom shku, secilën herë që kom shku ishe me njifarë frike normal se, po n'tjetrën anë kur shkojsha atje i shihshe do t'ri, do ma n'moshë, do kështu... t'u mushke njifarë energjie megjithate e mirë. Ose njifarë shprese ma mirë me thonë. Edhe kështu. Nuk kish autobus deri n'tre t'ditës domethonë, kështu që rrisa aty.

S'kisha ça me bo edhe hecsha gjithandej nëpër fshatra. Fshatin Zabërgj. Krejt fshatrat n'ren të Shalës i kom hecë. Edhe, qata e du shumë, shumë, shumë natyrën. Edhe prej atëherë shumë (qeshë). Edhe nuk preferoj me shku për vikend tash nëpër restorana ose kështu, ma shumë e preferoj natyrë.

Erëmira Krasniqi: Sa ka qëndru ai aty? Domethonë në '98-tën, ai ka shku në Shalë të Bajgorës?

Valdete Idrizi: Po, po. Ky...

Erëmira Krasniqi: A e ki vizitu shpesh?

Valdete Idrizi: Në t'parën herë osht' plagosë në Shqipëri, për armë atëherë që patën shku. Këtu {tregon me dorë afër syrit} e ka pasë rrok plumi edhe tani infeksionin e ka pasë fitu. Dytën herë u pat' plagosë në, prej njifarë gasi, s'ka pasë pa disa ditë, hiç s'e kena ditë na. N'tretën herë tani e ka pasë kështu me teha, me teha të Mazhiqit osht', njihet atje në Shalë, ku e ka pasë qët' pjesë t'dorës këtu {tregon prej nyjeve të dorës} edhe ka pasë copa e granatës në pjesën e djathtë {tregon me dorë kah pjesa e prapme e fundshpinës}.

Erëmira Krasniqi: A ka pasë shumë luftime në atë pjesë a?

Valdete Idrizi: Qajo njihet Beteja e Mazhiqit goxha shumë, po menoj njihet goxha për qat'... se aty ka vdekë ai Avniu që e ka një përmendore në Mitrovicë. Nashta e dini? Avni Shabani. Këta tjerët domethonë jonë plagosë disa. E une, unë kom bo praksë në Burimin. A din që s'ka ma, s'kish ma tmerr. Po, Bajram Rexhepi o konë qai doktorri, e tha "S'ka vakt me kajt këtu, po duhet m'u msu". Tha, "Se luftë osht' kjo, s'i dihet".

Erëmira Krasniqi: A shkove ti m'i ndihmu krejtve, a veç shkove pse ndëgjove për Burimin?

Valdete Idrizi: Jo, une tani shkojsha, se shkojsha që t'kallxova se ajo n'nantë ka qenë autobusi që 30 minuta bojke dej shkojshe, tani dej n'tre s'kish tjetër. Tani une shkojsha a fshijsha, a pastroj, gjithçka bojsha. Dilsha tani jashtë. Ose i marrsha fmitë e tyne, ose, gjithçka po menoj. Se s'kishe ça me bo ti gjithë ditën atje, atje n'katun. As s'mujshje ti me hi te ushtartë mrena, ose... po, s'po di, çkado që ish nevoja diçka me bo. Me zi kanjiherë ose çkado qoftë. A din, rriha deri n'tre. Normal që s'flejshe ose veç me nejt me një ven, po takojsha njerëz t'katunit. Kështu që, u... shkojke, shkojke ajo koha shumë shpejtë kur vike koha për m'u kthy anej.

Erëmira Krasniqi: E kur ja nisi bombardimi çka ndodhi me qytet? A ju përzonen a [larguan nga shtëpia]?

Valdete Idrizi: Po, neve na përzunën. Sidomos natën e parë, natën e parë kur, thjeshtë kur ja nisën bombardimet, na normal ishim n'banesë. Edhe, erdh edhe motra jem pej Veriut atje. Edhe ajo në Veri po në "Kodër të Minatorëve", një lagje tjetër, i pruni edhe fëmitë e vegjël, tre fëmi të vegjël. Edhe halla jem njejtë, t'njejtën lagje, edhe erdh tani te na, edhe diqysh.... E aty tani qat' natë ata i kanë vra një çift, domethanë burrë e gru, përballë banesës bash, ata n'dytin, i dyti kat.

Erëmira Krasniqi: Shqiptar?

Valdete Idrizi: Shqiptar, po.

Erëmira Krasniqi: Me çfarë motive, a veç kështu, po menoj...?

Valdete Idrizi: Po djali, djali tyne punojke me OSBE [Organization for Security and Co-operation in Europe] edhe ata, njo prej diqysh familje shumë t'rspektume n'qytet, Beqiri. Edhe i vranë. Tani i vranë njejtë në një, ka qenë në një dyqan që blejshëm gjithçka në Suhodoll, dy, dy djem të ri, dy vllazën. Njeni babë kështu i ri me dy fëmi t'vegjël, tjetri domethanë një djali i ri, s'e di nijzet e sa vjet i ka pasë.

T'njejtën, qat' natë është vra edhe Latif Berisha, edhe Agim Hajrizi, e tani veç pritshe kur po vjen te dera. Tani na erdhën edhe neve me maska n'banesë edhe, edhe thjeshtë na qitën shkallëve.

Aty ka qenë dikush prej kojshive tonë se neve nuk na, nuk na, nuk na hini kërkush kështu me shkelm. Qato, po menoj ça keni mujt me marrë qaty kena marrë. Mo s'kena mujt me.... Hiç as s'dishim as ku po shkojmë, as ça po shkojmë, hiç, hiç. Tani te ora e qytetit, ku osht' fillimi i urës prej anës të Veriut tash, qaty ka qenë ora e qytetit, aty na nali një patrollë, "Ku po shkoni?" E i ndajti burrat edhe neve. Bile djalin e kish motra, Meritonin, pesë vjet s'i ka pasë, ose ma pak, e ka pasë n'qafë, e kish. Edhe dashti me ia jep, tha, "Jo edhe djalin knej". Aty e di që, kom fillu me mendu që kanë m'i mytë krejt. Po dikush erdh i tha, a din, "Lshoni", edhe na.... Po ajo, ajo u konë njifarë episode që, i tmershëm a.

Erëmira Krasniqi: Natën a ditën?

Valdete Idrizi: Ditën, ditën.

Erëmira Krasniqi: Midis ditës?

Valdete Idrizi: Midis ditës. Po, po.

Erëmira Krasniqi: Po a? E kojshitë e juj?

Valdete Idrizi: Jo, s'i njofsha ata, se veç kalum na. Dikush tjetër qëlloi aty. Tani kemi shku në lagjen Tavnik te daja, aty kemi nejt. E di që kur i, i kena pasë numru 49 vetë kemi nejt n'atë shpi. Qeshtu flejshim ka shtatë-tetë. Sa erdhën p'i fshatit Çabër, domethonë dajtë tjerë. Atje veç fillun do probleme, telashe, domethonë veç erdh koha tani që e djegën krejt fshatin. Edhe rrishin aty. Deri sa nuk erdhën edhe aty me na qitë n'kolonë. N'atë kolonën e famëkeqe. Deri te Gjakova kemi shku.

Erëmira Krasniqi: N'kamë?

Valdete Idrizi: N'kamë, po. Me ato çantat, me ato... krejt ça, senet që i kishim se na çojshin për Shqipëri. Mendum që po shkojmë në Shqipëri. Ani pse përnime u konë shumë tmerr. Veç me, veç ideja që ki me shku, p'e lshon venin. Po, aty s'guxojshe m'u nal. Tonë rrugës i kena pasë pa njerëzit e vramë me çanta, t'ajun. Bash aty në Shipol, domethonë mrena hala në Mitrovicë. Tani, kah Skenderaj anej. E di që...

Erëmira Krasniqi: A u përcjellshit me polici?

Valdete Idrizi: Po, po. Qata s'guxojshe ti me shku kërkun. E di që në Klinë të Begut një njeri shkoi, thanë te ai lumi që osht' me marrë do ujë, veç kur snajperi e vrau, aty e la. Dashti me ngajt gruja, dikush prej kolonës e nali edhe, edhe vazhdoj kolona. S'guxojshe ti me lëvizë hiç, hiç. Edhe ajo u konë njona prej tmerreve përnime që s'ja kisha dëshiru kërkuj n'botë me përjetu. Ecshim ditën, ecshim natën. Taman u ulshim me pushu vike patrulla n'ato farë kerret e paramilitar, tylifare vishin. Edhe na thojshin, "Çonu, ecni". E di që kur na patën kthy kur mrritëm gati te ajo ura në Gjakovë, domethonë pak para se me hy në Gjakovë, erdh njifarë urdhni na thanë me u kthy mrapsht.

Edhe, jemi kthy në një fshat Gremnik. E aty kemi nejt disa ditë, s'e di pesë netë a gjashtë netë, nuk m'kujtohet. Po qaty kemi nejt, edhe kush ku ka mujt. Na e patëm qat' fat n'shpi t'djegun me nejtë. E di

që ni derë e kom pasë si krevet edhe ni guri e kom pasë si jastak, se s'kishe çka. Edhe, edhe domethonë komtë na u patën bo krejt asi si pufalla kështu, varrë asi, t'u hecë gjatë. Aty tani kemi nejt disa, disa netë e ditë. Edhe u konë përnime, u konë, u kon tmerr. Po, m'u kthy ka ana tjetër ai farë ballanci nashta, sa rrishim qaty t'zanun rob, s'e dishim kush po, ça po bohet tek po bohet.

Nijshim, erdhën e murrën këto, s'e kthyn këto. Do nana t'reja, e di që kanë marrë vajza... krejt u folke aty nëpër atë fshat. E që s'i kanë kthy. Dikon e kanë kthy. A din? E tash t'u i dëgju këto na mrena qasaj me dajë, me motër, me nanë, na i kemi pasë 15 fmi nër 15 vjet. Tani une lujsha me ta. Marojsha klikera p'i lloqi. Bojshim shfaqje. Domethonë t'zanun rob njonën anë, edhe s'kishe ça ha, çka me hangër. E di që pata shku me vjedhë kallamoqa. A din asi t'egër që s'u zbutshin, po për çudi s'na kapi asnji smundje, a din?

Kjo osht' një përnime fenomen se s'kishe ça me hangër. Hajshe ato t'papastrume mirë, as s'kishe as n'çka se t'djegta krejt. Edhe une lujsha me fmi, a din? Edhe diqysh po get t'u i, se dojsha veç m'i afriu ata mos m'i ndi qato storje gjithçka.... Edhe përnime njerzit jonë rreh për miell se s'kishe, kurgjo s'kishe.

Erëmira Krasniqi: Sa njerëz ishit aty?

Valdete Idrizi: Nuk e di, po se di.... Bash një ditë s'di kush e kish shkru një, një, kish shkru diçka për këtë kolonë e dojsha me ditë saktësisht. Veç a din qysh, mijëra, mijëra njerëz. Ti s'ki mujt me pa fundin. S'ki mujt hiç. Sepse qysh prej krejt lagjeve disa, një kolonë e kanë çu anena kah, neve Gjurakovci për fshtrat domethonë Bresalc e Zllakuqan, e atë tjetrën e kanë çu për Pejë. E për shembull gjyshja jeme, axhallarët e mi kish përfundu n'atë tjetrën kah Peja. Edhe na atje, na domethonë n'këtë lagjen, n'këtë kolonën tjetër. E di që në Zllakuqan natën, kurrë s'e harroj qysh na kanë pasë dalë do familje na kanë pasë dhonë bukë. Edhe ka një copë t'zezë...

Erëmira Krasniqi: Shqiptar?

Valdete Idrizi: Shqiptar jonë konë. A din ato do fshatra që jonë, veç thojshin, "Jon dalë katoliktë po na jepin bukë". A din e njëjshë nëpër kështu. N'terr, ti n'kolonë. Qatë natë bile e kom hup nanën, se terr nuk.... T'u ecë, t'u ecë veç kur e kom pa... ose une kom ecë kadale, ose ajo, edhe jena hup. Dej nesrit nuk e kom taku. Po, desha me tregu këtë pjesën me bukë. E kom pasë edhe une, ka qenë Naimi një, tash e kemi dhandër, ka qenë vllau i shoqeve ma t'mira t'mijat, edhe ka mbetë me familjen teme domethonë. E tash, ai domethonë bukë tash kqyrshim me, me, me na ra ka një copë.

Mu m'ka ra bukë, atij ni copë djath. E thojshim, "A i dajmë ka pak?" Q din? Edhe t'më ka ra n'tokë. E aty me bo m'u gërbavë metshe se kolona hecke. Kuku, masnej thojshim a din kanihere, kur s'ta don kanihere (qeshë). Tash, tash po qeshi po atëherë u konë njëfarë, s'po di. Ose, ose kur e thirrsha, "Nanë", ajo tani krejt u lajmërojshin "Hë," a din? Se aty nana shumë n'kolonë, ku mujsha me ditë cila. S'mujsha me thirrë nanën Hajrije, për shembull, n'kolonë a din? Thojsha ma njeh zonin. Deri të nesërmen, me dajën tjetër ish, ish metë. Ku me ditë t'u fol, ose kështu edhe jemi nda n'terr.

Erëmira Krasniqi: A ecshit natën? Edhe natën?

Valdete Idrizi: Po, po.

Erëmira Krasniqi: Non-stop a?

Valdete Idrizi: Unë po t'tregoj, nonstop. Kur kemi shku n'dalje të, domethonë n'hymje të Klinës, ka qenë njifarë, njifarë pjese, kurrë ma ftoftë në jetë s'e kom pasë. Kurrë, kurrë, kurrë. Kurrë ma ftoftë. Qaty e kom gjetë nanën edhe e di që me trup ja nxejsa gjysën e trupit. Me trup temin edhe trupin e saj. Kjo pjesa tjetër krejt akull. Edhe, qaty kemi flejtë, kemi pushu s'di sa. Nashta disa orë. E veç kur vishin tiiiit {onomatope} me kerre t'shtishin me ecë prapë. E atë ditë tani kena ecë dej qatje gati te Gjakova nëpër Klinë, n'qytet anej, tani do farë arash n'rrugë kështu kryesore që osht' atje.

Kurrë s'kisha pasë shku përpara n'atë rrugë. Tani veç na kanë shti n'qatë farë katuni. Tash dikush ka pasë një fat naj shpi kështu normal me nejt. Ka pasë n'atë fshat kafshë të ngordhne kështu, a din t'ajne? Qysh po u bojke trupi nashta si po rrike disa ditë. Edhe ka ra shi shumë. Tonë kohën bike shi, na t'u ecë. Tmerr. Seriozisht tmerr.

Erëmira Krasniqi: N'atë fshat, çka ish plani n'atë fshat me ju bo juve? A veç me pushu ju nalën a?

Valdete Idrizi: Po, po get ka ardhë urdhni mos m'i, a din mos me na lshu në Shqipëri a ku ta di une. E veç qaty t'u hecë. Ai, ai fshat ish in shku ata ma herët në Shqipëri a, që ish in shku tani. Se nuk gjejshim banorë hiç t'fshatit.

Erëmira Krasniqi: I kanë zbrazë?

Valdete Idrizi: Po, i kanë zbrazë ma herët. Disa shpi t'djegne, disa veç t'demolome, disa kështu normal. Edhe tash kush ku ka mujt ka hy domethonë. Për shembull, n'qatë dhomë ku kena nejt na nja tri-katër familje jonë konë. A din, qaty rend qeshtu flejshim. Tregova e gjejshëm një derë diku tjetër e mora, qeshtu tani t'u bojke vija trupit, krejt trupi. Bile ai u dokke sikur asi kreveti mirë, se masi u gjetë, se n'tokë.

Erëmira Krasniqi: A kish polici manej, a ju braktisën edhe ata, veç ju lanë qaty?

Valdete Idrizi: Jo, ata ish in n'rrugë kryesore. Qysh ish fshati, rruga kryesore këtu {ilustron me duar}, na tashi nuk ish in larg, fell shumë mrenda. Domethonë, se s'goxojshe as fell se s'dishe ça po të...

Erëmira Krasniqi: Gjenë?

Valdete Idrizi:... ça po t'gjenë. Edhe gjithë me kallabllak dojshe me nejt. Ditën tani dilshëm, ecshëm anej me kqyr kush tjetër osht' nëpër.... E, kurrë s'e harroj një profesor t'fakultetit, e kom pasë profesor Ejup Qerimin, mas luftës jena taku, edhe i thashë... s'po di ça m'erdh rond kur ja pashë do kpuca asi, asi oponga t'llastikut, se po get edhe atij ju kanë prishë t'u ecë, kur e pashë, nashta edhe profesor, qaq rond e niva kur e pashë, edhe i thashë, "O profesor," thojsha, "po m'vjen marre prej vetes." Thashë, "Kur lexojsha për Holokaustin edhe thojsha hajt more se p'e ekzagjërojnë pak se s'munet me konë qaq keq. A din?" Thashë, "Veç shyqyr që s'i kom thonë kërkujt po e kom majt për veti këtë menim." Thashë, "E po m'vjen marre." Thashë, "Se s'paska kush që din me përshkru vujtjen."

Qatëherë mo ish in pa bukë, e pa kurgjo, a din? A din kështu kur thojnë, se di. Tmerr. Edhe komtë de po t'u përgjakshin. U shtyjshëm de po thom, kur e qitshim n'diell qaty në Gremnik kujna p'i thahen ma shumë ato pufallat, e na u trashke lëkura. Gjithçka mo. Po, është një periudhë e jetës shumë, shumë e

ranë, shumë, shumë e ranë. Edhe, du mos me harru. Du me kujtu, du mos me harru se tani me, me vlerësu edhe këta çka e kemi sot. Domethonë, mundësitë çka jonë sot për m'i bo senet ma mirë. Domethonë, njerëzit që kanë shpëtu. Se ka tjerë që i kanë hup.

Erëmira Krasniqi: A dolet në Shqipëri ju mandej?

Valdete Idrizi: Jo. Jo jo, s'jena dalë në Shqipëri se na kanë kthy. Na kanë kthy qaty në Gremnik. Na disa kilometra u kthym mrapsht. Prej Gremnikut as s'dishim kur vijmë, as kur na thojmë. Na erdhëm me kolonë prapë n'komë me u kthy në Mitrovicë. Tonë ato kilometra. Jemi kthy ne Mitrovicë. Kur u kthym në Mitrovicë qa me pa? I pajshe dikun, dikun i pajshe do shpija t'djegne, dikun t'shkatërrume, dikun... gjithçka tu ardhë te poshtë. Bile unë me nanën, i shpërthyn venat n'kom, s'mujti mo me ecë. Kena met veç, veç na dyja patëm met atje nalt në, te fshati Lushtë tu zbritë për të, për Shipol.

Kemi met te ni dyqan se tha s'muj me ecë mo. Tha, "Lem mu, ti shko." Thashë, "S'muj." Se ka qëndru shumë po ka pasë problem me vena e i pëlcitën. E u shike se me një shami veç ja lidhëm ma herët. E tani, e di që i bërtitsha edhe kajsha sa mujsha, "Po do me na vra dyjave qitu". Diqysh e padrejtë, po prej tutës që edhe ate edhe mu p'e vrainë. Edhe krejt shkun kolona na metëm. Edhe e kalum njifarë rruge qaty. Edhe jena hi me ni shpi. Kishim pasë ecë goxha se tek t'nesrit e dita ku jom. Kem pasë hi me një shpi, as rrymë as kurgjo s'ka pasë hiç. Edhe tu prek, t'u vra, dikun t'u rrxu e kena gjetë do bukë.

E kena hangër ata bukë. E dajta përgjyhtë, e kur e kena pa t'nesërmen, po get pi lodhjes edhe pi unjes t'madhe s'po mujshe me hongër shumë. E t'nesërmen kur u bo ditë, se s'guxojsha as me dhezë diçka edhe me dashtë, se s'dishe çka ka, kur e kena pa ata bukë t'mykun, krejt kështu a din t'gjelbër ngjyra. Po qaq neve na kojti, a din, natën, sa që s'dojshim me ndi. Edhe kurgjo s'na gjet. Tani t'nesërmën një kolicë e gjeta nëpër shpija aty. Ishim shku gati na te fshati Zhabar. Ish një rrugë teposhtë. Edhe kur erdh një njeri, na kish ndi zhurmë po get se aty t'u lyp, t'u u rrxu dej sa gjetëm ku me nejt dej sa t'bohët mëngjes.

Edhe kur shkum aty me një, ma dha një kolicë. Tha, "Me qitë nanën n'kolicë". Edhe me kolicë kemi shku atje teposhtë, e kena kalu rrugën edhe jena shku në Tavnik. Prapë te daja, po te ai gjysën ja kishin shkatërru, s'kishe ven. Tani t'nesërmen na gjet Burimi, vllau e kish gjetë një shpi të një i familjes aty, një shpinë e axhës vet që kishin dalë në Shqipëri. Aty tani kemi nejt në Tavnik. Deri sa si erdh reni i kolonës tjetër, n'stacion që na kanë pasë vendosë. Ato jonë ngjofshëm për mitrovicasit kush ka qenë aty, në kolonën e stacionit. Edhe aty i kanë marrë shumë i kanë vra. Do s'jonë hala, domethonë n'listën e të zhdukunve. Edhe tani...

Erëmira Krasniqi: A mujshe ti me shku te Burimi n'atë kohë najhere?

Valdete Idrizi: Jo, po Burimi tash kishte ardhë knena, knena ka Tavniku kishte, knej kishin zbritë. Edhe ky u shëru me dorë t'majtë, veç vazhdojke me qenë ushtar. Edhe, domethonë metëm në Tavnik, n'qatë lagje. Edhe s'kishim, se na s'kishim fort kërkon edhe atje nuk e dishe se s'mujshe me marrë informata çka po ndodhë ti. S'kishe mo as lluksin me shku, n'çfarë shtate. Për shembull, familja e Naimit që ish me neve, kishte metë në Bisticë atje, në komunë të Leposaviçit krejt. As s'dike çka po ndodhë me ta, as ata t'u mos ditë çka po ndodhë me te. Neve, një epizodë shumë e ranë, shumë e ranë t'u u kthy.

Te fshati Llaushë n’hymje të Skenderajit, qaty i kanë nda krejt burrat i kanë marrë, krejt. Tre dajë t’mi, burrin e motrës edhe qët’ Naimin. Edhe që thashë, tash e kemi dhandër. Tash pesë veç t’familjes tonë i murrën. Edhe në lajme thuhej që i kanë vra, i kanë bo kështu. Tani mas një kohe, gati një muj u bonën sa kemi nejt na, tani pritem kolonën e dytë e krejt, kur i kena pa qat’ njonin prej dajve t’madh n’fotografi me t’familjes t’vet në Shqipëri në kamp. Ata i kemi marrë, masnej i kishin çu n’burg të Smrekonicës, maltretu e krejt, tani i kanë çu për Shqipëri. Edhe tash, po ajo që nuk dishim çka po ndodhë me ta.

Erëmira Krasniqi: Prej kahit merrshit lajme? Çfarë lajme të Serbisë a? CNN?

Valdete Idrizi: Jo. *Deutsche Welle* nëse t’kujtohet, e nijshim zonin e Lindës, motrës që ish në Gjermani, e nijshim, “Nuk di asgjë për fatin e familjes time”. Veç një, një, një shpi në Tavnik domethonë, edhe ai ish axha i shoqës teme që na lejke me folë, ia jepshim qat’ numër, vllaznit që thirrshin pi Gjermanisë. Edhe qaty për me ditë që jena mirë. Edhe kur e nijtëm Lindën t’u kajt aty, shumë ish ronë. I nijshëm ato lajmet. Tani të Kosovës, tona lajmet e mundshme i ngojshim qato çka t’mujsim.

Tani mas atyhit, mas kolonës dytë në Tavnik, edhe aty një, një domethonë e tmerrshme ke edhe ajo. Gjithë ditën na majtën aty. Vijshin veç thojshin “Ti, hajde”. Unë e di që Arianin, djalin e motrës t’madhin, edhe ashtu ishin shumë, shumë keq se s’dishin a ja kanë vra babën a jo, ai ish 15 vjet Ariani qatëherë, edhe ja veshëm një kësi jelek t’leshit edhe një shami për m’u dukë si çikë. Se thojshim... ai s’dojke, bërtitke se s’e dijke. Edhe shpëtoi pa e marrë. Domethonë, se i marrshin edhe me 15. Tani as s’dishim ku jonë a ku p’i çojnë a.

E di që vëllaun e ni shoqes e kanë vra qaty. Edhe, tani kanë ndodhë shumë, shumë, shumë gjana tjera t’u u kthy n’kolonë, tu t’kthy dikun, ose.... Na tani prapë jemi kthy në, n’qatë shpinë në Tavnik. Deri sa erdhën policinë se tani e kishin ditë që familja e Burimit, e tash Burimi i rrezikshëm, e na kishin lyp. Burimi tha, “S’keni qare pa shku në Mal të Zi”. Une kategorike mos me shku. Thashë, “Nuk du me shku”, thashë, “se po du... ” Se ju gatujsha, ju bojsha gjithçka. Ndhmojsha. Tani, një çikë u pat’ plagosë, shkojshim nëpër shpi mledhshëm fasha. Unë u bona njifarë lloj eksperte tani, se t’u u, t’u ushtru me vllaun.

A din i nimojshim domethonë njerëzve, qa ishin t’plagosun diku edhe diqysh ma aktive gjithë ditën rrishim gjatë lufte. Edhe për ata s’dojsha me shku. Tani, tha, “Jo,” tha, “nëse rrin qitu” tha, “ata, Ratko Savići, qata polictë që jonë konë” tha, “u ardhë qitu, n’këtë shpi”. Tha, “Bash p’e lypin, e qysh do me lonë edhe Vjollcën me fmi”, motrën e madhe. Edhe jena hyp n’autobus. S’kishim as pare, 150 marka ka kushtu një biletë. Tani... 150 marka...

Erëmirë Krasniqi: Deri në Mal të Zi?

Valdete Idrizi: Po.

Erëmirë Krasniqi: O Zot!

Valdete Idrizi: E di që i gjeti Burimi pi dikujt. Edhe, tani hypëm n’autobus. Qaty e di që kurrë vaji s’mu ka nalë. A din kur s’nalet kurrë, kurrë hiç? Se ke ma e ranë se edhe kolona tani. Se që e lash edhe ata, edhe e lash venin. E tani t’u shku rrugës e kena pa edhe Çabrën që s’ka, s’kish mo shpija hiç, hiç, hiç. Se s’dishim ne çka ka ndodhë, e në Çabër i kom pasë dajtë. Asnji shpi, hiç. Edhe tani jena shku në Ulqin

edhe kena nejt në kamp. Ani pse tezja e kish një shpi, s'dojshim me nejt aty se... një shatorr, veç mu e nanës, një shatorr tani motra me fmi.

Po tani masi e pamë dajën që ka dalë në Shqipëri, motra e gjeti një mundësi, i nimun prej jashtë edhe shkoj në t'zezën në Shqipëri me gjetë burrin. Mos e ka edhe burrin ajo. Edhe e gjetë. Ajo shkoi atje në Shqipëri. Une nana metëm në, në qaty n'kamp. E aty ke shumë e ronë n'kamp se veç shkojshe me ngu lajme. E ngojshe, e shumë, shumë periudhë e keqe u konë. Tani kur thanë, qaty e kom marrë lajmin që u shliru. "Kush be u shliru?" Se mo s'ta kapke truni hiç.

Erëmirë Krasniqi: Sa gjatë ju ra juve me nejt aty?

Valdete Idrizi: Disa javë. Domethonë une kom shku, e kom lshu domethonë dikun gjysën e majit, ose fundit, fundin e majit, se as një muj s'kom nejt në Mal të Zi. Pak para se me hy domethonë trupat... sa me përjetu edhe ato t'qenurit refugjatë kur thhojnë. Se e tmerrshme me, me pa, me një, me mungesë t'informacionit me nejt. Qaty tani ju besojsha edhe ktyne jashtë që dojshin m'u çmendë se s'po dinë çka po ndodhë. E sidomos kur s'don me konë jashtë kur gjithë je konë tonë kohën aty. Tani, tani nuk na lanë se dojshim meniherë n'fillim m'u kthy, po s'lejshin se u tutshin jo mina që bishin disa raste. Vullnetarisht, e ti vullnetarisht s'mujshke kombin pi Malit Zi m'u kthy.

[Pjesët në vijim janë realizuar në Mitrovicë më 28 maj, 2017]

Pjesa e Tretë

Erëmirë Krasniqi: Valdete a mundesh me na tregu atë ditën kur jeni kthy në Mitrovicë edhe qysh e keni ditë që mo nuk mundeni m'u kthy në Veri, serbët që jonë konë aty?

Valdete Idrizi: Na, kuptohet kur u kthym, edhe ashtu menxi s'přitshim m'u kthy edhe normal m'u kthy n'shpi, m'u kthy atje n'venin tonë, n'pjesën e veriut. Kur erdhëm na veç kishim ndi, prej njerzve në autobus a s'e di qysh, kishim ndi që nuk p'i lojnë me shku në Veri. Po diqysh, diçka kur s'të pëlqen, a e ke pa, nuk e... nuk e pranon qaq lehtë. Edhe mrrijtëm. Shkum njihere domethonë m'u taku te daj, me pa vllaun ma s'pari që s'e kishim pa. Edhe ashtu kishim ndi tylyfarë fjalsh që a osht' mirë, a s'osht' mirë a? Edhe menjherë deshtëm me ardhë, domethonë te ura, edhe kur i pamë këtu krejt me tela. Domethonë, ura, nuk lejshin me shku. Ushtarë, franqezë, a din... çka u bo? Qysh domethonë qysh m'i ja bo?

S'di a jonë koën telat a jonë konë veç ushtartë, s'më kujtohet. Veç e di që fizikisht nuk mujshke me kalu. Edhe s'kishe as ku me shku, s'kishim na shpi. Edhe masnej vllau na e gjetë një shpi për me nejt veç dy javë, tri javë sa kem nejt një banesë ish e dikujt, një familjes shqiptare që e njifke, për me nejt pak kohë, dej sa t'kthehëm. Megjithatë, s'thojshim dej sa t'gjejmë naj tjetër, po dej sa t'kthehëm. Edhe kur e pamë diqysh u vështirsu. I takojshim njerëzit, domethonë njejtë kojshitë tonë të Veriut, "Jo, s'po na lojnë". Kish, nijshim fjalë tylyfare që kanë qitë mina nëpër banesa, edhe me dashtë me shku dikush në t'zezën ka ura s'bon, ose me shku thjeshtë në rrezik t'vetin, nuk lojnë.

Patëm provu me shku si grup. Jonë konë do protesta që patën organizu krejt deri në Veri. Tani gjujshin me gurë, piskitshin. Ushtria tani na kthejshin, ushtria franqeze, KFOR-i. Edhe diqysh, vështirë me pranu, diqysh e pamundun me pranu që s'munesh thjeshtë m'u kthy, as s'ki, kur s'ki çka bon. Paramendo unë e kom pasë veç një fustan edhe një maicë, edhe domethonë sene krejt personale,

kurgjo tjetër s'kom pasë me veti, hiç. Se ato veç ishin, që i kishim t'trasha për kolonë, tash koha veç domethonë u nxe. Kurgjo s'kishim. E tash t'njejtën, t'njejtën kohë, jeta vazhdojke. Duhet, duhet diqysh me jetu edhe lypsha punë, çdo ditë dilsha.

Tjetrën anë knej njifarë lufte me shku në Veri, veç dojsja me hi ngat ure m'i taku njerëzit, thjeshtë a ka naj ide a qysh me shku, n'tjetrën anë dilsha me lyp punë. Kur i gjejsja do konkurse edhe domethonë n'kom, s'kishim as kerr as kurgjo tjetër atëhere. U konë edhe qajo periudhë shumë e vështirë se tamon shkojshe, vishe n'ren për intervistë dikun, t'kthejshin. Knena u kthejshe n'shpi, faktikisht s'kishe kurgjo. Na normal me hongër me pi kishe se vllaznit prej Gjermanisë na ndihmun, domethonë na i kishim, po thjeshtë nuk kishe kurgjo domethonë thjeshtë ku me jetu.

Dy javë me ni shpi, tani shkojshe me ni shpi tjetër. S'e dishe a po kthehesh, se njerzit u kthejshin edhe ti u detyrojshe me lshu. Edhe shumë vshtirë domethonë kjo pjesa e shprënguljes, ani pse tesha s'kishim, ose sene s'kishim na shumë, shumë lehtë n'qatë aspekt, po emocionalisht shumë vështirë kur e dishe që je e pasigurtë. Domethonë, thjeshtë s'e dishe të ardhmen tone, thjeshtë ça ka m'u bo me ty. T'njejtën kohë s'mujsh me ju gëzu as atij çlirimit, domethonë kur i pajshe nëpër televizor ose lajme ose njerëzit t'u festu, domethonë n'shpija t'veta, ti e kishe diqysh gjysmë atë gëzimin.

Njonën anë normal u gëzojshe se s'e kishim atë frigën që thjeshtë, frigën që ki me vdekë, po, a din, po n'tjetrën anë ajo frika e pasigurisë, thjeshtë ça po donë m'u bo me neve, a din, e kur, e qysh? Knena i besojsha, se ajo njifarë shprese që s'po hupke kurrë. Hajt se edhe qët' shpi tani s'besoj, prej kësaj kena me shku n'banesë, a din. Gjithë e kena pasë domethonë këtë ndjenjë.

Erëmira Krasniqi: Sa zgjati kjo periudhë?

Valdete Idrizi: Huh, kjo zgjati shumë. Faktikisht kjo edhe sot...

Erëmira Krasniqi: Edhe sot.

Valdete Idrizi: Edhe sot, domethonë edhe sot po zgjatë se edhe sot nuk, e ki atë, domethonë e ki atë mungesën, se thjeshtë s'mundesh me shku, t'u ka mohu qikjo e drejtë. Po tani, fatkeqsisht po thom, u msumë pej një shpije një tjetër, a din? E tonë, me këto vjet nimdhjetë shpija, domethonë nimdhjetë vende na kemi.... e tash, ndërkohë hyna n'punë edhe t'u u munu me majt, kur thojnë, edhe atë shpresën, atë moralin, knej edhe me mujt me.... Thjeshtë, u deshke gjanat elementare me i ble. Po flas domethonë prej gotave, prej shporetit, prej gjanave, gjithçka me nisë prej fillimit.

Taman u stabilizojshim me një shpi edhe u dashke me shku me një shpi tjetër. Ose u kthejshin që i kthejshin prej jashtë familjet edhe 'm'ka ardhë vllau, m'ka ardhë motra, m'falni duhet me liru'. Edhe secilin vjet qiraja u bojke edhe ma e shtrejtë, domethonë edhe kjo pjesa tjetër. E në mënyrë paralele u munojshim më këtë, me Habitatin për shembull që ata veç e murrën në, në menaxhim, domethonë menaxhimin e pronave në Veri, e kish faktikisht n'mandat të tyne. Edhe ty kurgjo, absolutisht as me liru. E morrëm vesh domethonë kush osht' n'banesë tonë.

Thojshin ani shkoni ju n'banesë të tyne. E ti tash n'banesë të tyne qysh me shku kur ato n'atë kohë i kishin pasë marrë kështu n'kohë t'rezhimit, a din, ish kontestuse prona edhe tash s'mujsh ti m'u vra me njerëz, "M'falni se po du me hy". Kështu që, knena kurrfarë, s'ishe ti prioritet more i lidershipit tanë, hiç absolutisht. Ndërkohë, u konsiderojsha goxha fatlume se megjithatë punojsha edhe jetojsim mirë nëse muj me thanë.

Erëmira Krasniqi: Çka fillove me punu mas luftës? Domethonë qysh u gjinde?

Valdete Idrizi: Po, mas luftës, njo nontë herë, a dhjetë vena që kom zhgënjime t'thom. Jom pranu për intervistë edhe kur vike koha për intervistë s'merrshin, ose dikend tjetër ose... mas goxha dëshprimi disa here, ma n'fund e takova një mike ku m'thotë, "Oj Vali", masi kisha luft n'teatër shumë gjatë isha aktive, tha, "kom dëgju," tha, "osht' ni program i danezve, program social. Po lyp instruktore të teatrit." "Po a?" "Po". Edhe po ngaj edhe menjherë e çova aplikacionin edhe u pranova. Maspari isha si instruktore e teatrit me punu me fmi. Edhe u knaqa se une edhe fminë i du ashtu kështu edhe në tjetrën anë veç që u angazhova dikun.

Nuk ish ni pagë shumë, shumë e mirë po mjaftojke për me ja nis diqysh prej fillimit. Domethonë njo prej, hajt t'thom, përvojave ma t'mira, se diqysh punojsha, t'njejtën kohë edhe t'dhimshme, se punojsha me fmi që përnime kishin hup prindtë gjatë luftës, ose njonin prind, ose fmi të traumatizim që kishin problem edhe me fol, me u shprehë fillimisht. Tani ma vonë fillova me punu me fmi që shitshin rrugës cigare, edhe ose diçka tjetër që shitshin, ose kësi sakëza ose diçka, domethonë fmi t'rrugës.

E fillum me ta me bo shfaqje teatrale. Në tjetrën anë une si duket t'u punu me fmi e edhe vetën diqysh ja ngrita edhe moralin, edhe disponimin, edhe energjinë, edhe pozitivitetin. E më pas menjhere, në të njejtën organizatë më promovunë në pozitë. U bona menaxhere e Qendrës aty, ku ishim nja 18 punëtorë.

Erëmira Krasniqi: Çka bojshit ju si Qendër Kulturore, po menoj komuniteti....

Valdete Idrizi: Qendër e komunitetit, Qendër e komunitetit, program psiko-social ku ishin domethonë prej aktiviteteve të grave, fillimisht me punë dore atëherë krejt ose me maqina t'qepjes, me program për fmi qoftë teatër, qoftë muzikë, aktivitete t'sportit të ndryshme. Edhe domethonë kishim edhe disa grante ma vonë ju jepshim ose i bojshim disa prej projekteve. U msumë me shkrujt projekte, m'i zhvillu projektet. Unë ani pse isha tash si udhëheqëse e Qendrës vazhdojsha me u aktivizu edhe njherë me "Meselation" me këto, si e përfundojsha punën.

Domethonë unë e kom vazhdu punën vullnetarisht edhe me, me teatër. Kemi, i kom realizu katër shfaqje me fmi edhe në të njetën kohë shkojsha n'aktivitete tjera. Une si, jom msu gjithë, kurrë s'kom bo veç një punë, gjithë kom bo paralelisht domethonë krahas një pune edhe aktivitete tjera. Pata fillu në nismat e, ndër t'parat, edhe pse isha hala pa punë, kanë qenë do nisma për dialog për Veri. E kisha njifarë nevoje me, edhe m'i dëgju qata bashkëmoshatartë e mi të Veriut, çka kanë me thonë për ata ça ka ndodhë? E dyta, dojsha m'u kthy edhe dojsha me çdo mënyrë edhe çdo, çdo aktivitet me qenë prezente edhe me kërkun qat' të drejtën tem m'u kthy.

E kjo tani t'u qenë pjesë e këtyre nismave, a i organizojshin OSBE-ja, a një organizatë norvegjeze, domethonë nisma, s'ishin unë që i kisha inicu po dojsha me marrë pjesë. Edhe takojsha njerëz edhe diqysh i dëgjojsha. Edhe për ta u konë lufta, edhe pse e pritun në njifarë forme, megjithatë e papritun. S'ishin që ishin tash t'lumtun që ka ndodhë ajo. E kështu, fillum me dëgju edhe pjesën, edhe pjesën tjetër. Ndërkohë, isha një ditë n'punë atje te danezët, i dëgjoj dy vetë t'u fol në radio, Radio Mitrovica atëherë është, filloi punën, i dëgjova dy musafirë t'hujë. Kishte atëherë që vishin t'hujë plot edhe me ndërto shpija, me ndërto rrugë, me ndërto gjithçka.

Po qajo ça m'pëlqeu, ça dëgjova, edhe isha para se me mbyllë domethonë zyren atje ku punojsha, një lagje në Tavnik, në Mitrovicë. Thanë, “Ne këtu jemi përfaqësues të një organizatës holandeze që merret me ndërtim t'paqes. Kemi përvojë në Kroaci, në Bosnje. Edhe jemi ardhë m'i dëgju njerëzit, m'i dëgju a kanë naj ide, nëse mundem na [me ndihmu] me ekspertizën tonë. Do t'shkojmë n'gjitha qytetet e Kosovës të shohim.” Qajo që mu m'la shumë përshtypje, edhe m'boni me mbyllë zyrën shpejtë edhe me nga mi nxon n'studio, ish qajo ‘mi dëgju’. Edhe thashë, kur atëherë gjithkush vishin me na mësu ‘bone k'ta, bone k'ta’.

Për mu hera parë përnime dikush [thotë], “Po du me ju dëgju ça me bo”. Ani pse në të njejtën kohë s'disha ça kom m'i thonë, po ngajsha edhe shkova atje edhe i takova shkallve, është dy holandezë, Miriam Strajk edhe Dion di Vonderberg, tash i njoh se i kom miq. Edhe isha mushë frymë t'u nga se larg, as s'kisha kerr as, as telefon, kurgjo s'kisha. Edhe po ngaj edhe ju thashë, “A jeni ju ata dy holandezt që folët?” Tha, “Po”. Thashë, thashë, “Ju keni thonë, që m'pëlqeu” thashë, “ju keni thanë që jeni ardhë me ndëgju diken.” Thashë, “Qe une jom ardhë me ju tregu me m'ndëgju mu.” Veç kur jonë nal “Ou”. Thashë “Po”. Tha, “Çka?”

“Po, krejt” thashë, “që po vinë ndërkombëtarë po na kallxojnë ça me bo edhe krejt po marojnë shpija e krejt, krejt, krejt edhe kërkush s'po donë me punu me njerëz.” Thashë, “E une po ju thom osht' mirë me punu me njerëz. Unë jom e Veriut. S'po muj m'u kthy n'shpi. E di që për m'u kthy duhet me, me bash, me fol me ata të Veriut.” Tap, tap, tap {onomatope}. Ata ishin t'u u gutë se s'kish as hotele në Mitrovicë atëhere, dojshin me shku në Prishtinë edhe thanë, “Ku munem me t'taku?” Ja shkrujta me ni letër, une i kisha në një ndërtesë tjetër ato kurset që i majsha me teatër me fmi edhe thashë, “Prej kaq, ora kaq, jom me domethonë këtu.”

Edhe diqysh ju besova që kanë me ardhë. Ani pse gjysa jem thojke, “Hajt more shkojnë edhe këta në Prishtinë, gjithçka atje ka m'u bo, s'kanë m'u kthy”. Po diqysh një gjysma jeme thojke, “Po, po, kanë m'u kthy e kanë me m'dëgju”. Të nesërmen kanë ardhë këta dy holandeztë. Edhe erdhën sa isha me fmi t'u punu. Une veç me kokë ju thashë, “Uluni”. Edhe vazhdova punën me fmi. Si e përfundum, e nisëm domethonë muhabetin edhe ata tani kanë ardhë vazhdimisht edhe bashkarisht e kemi, e kemi zhvillu projektin që tashi, ma vonë u bo organizatë që *Community Building Mitrovica [CBM]*.

Po n'kohë paralele isha edhe punojsha atje në Qendër në DRC [*Danish Refugee Council*] që punojsha, edhe e zhvillojsha domethonë këtë projektin, n'fillim u qujke, jo organizatë. E t'njejtën kohë m'dha qaq shumë vullnet, qaq shumë shpresë që qiky qytet ka m'u bo, ka m'u bashku e une kom mu kthy n'shpi. Se t'u i zhvillu idetë, t'u fol me njerëz, se na s'ish që veç na u ulshim, po çdo ditë iksha pi punës atje, i kryjsha do punë, kolegëve ju thojsha, “M'fal se për Veri diçka”. Dilsha pi punës, shkojsha përkthejsha, a n'shkollë t'muzikës, a me kryetarin, a me... domethonë veç me i bind ata që kena me bo diçka këtu bashkë.

Edhe qashtu e kemi nisë domethonë këtë CBM-in, organizatën. Tani atje punët shkojshin shumë mirë. Dhashë dorëheqje në DRC se domethonë dashta në CBM me nisë diçka prej fillimit me punu me t'ri, me punu me gra, me punu domethonë me krejt komunitetet. Mirëpo, ajo që gjithë kom dashtë, sepse për me dashtë me bind dikon oshtë, ndryshe osht' veç kur ti thush osht' mirë me punu bashkë, e me i nda vlerat e përbashkëta, me zhvillu ide bashkë, po kur t'ja dëshmojsh vet, kur je model ty t'shohin që punon bashkë, ndryshe osht' ndikimi. Edhe CBM-i, domethonë bashkë me kolegët tonë serb e shqiptar, fillimisht dy zyra kanë qenë një në Jug një në Veri, e kemi pasë një holandez këtu si, si menaxher.

Tani, kom qenë ndër t'parat që e kom lyp, thashë nëse dojmë duhet bashkë se s'munëm ndamas, se kurrfarë efekti s'kena me pasë. Edhe ajo kërkesa jem menjihërë erdh parasysh edhe.... Maspari jena taku në Holandë. Edhe jena taku edhe une isha shumë, shumë këmbëngulëse që nëse dojmë me pasë sukses veç duhet me konë një zyre bashkë edhe serb edhe shqiptar.

Erëmira Krasniqi: Domethonë herën e parë serbët i ke taku, domethonë t'qytetit tonë, i ke taku në Holandë a?

Valdete Idrizi: Po, fatkeqsisht a din, po. Dhe domethonë njenin e njëfsha, Dejanin, se ish gjeneratë me mu. Ai muzicent, domethonë një rock muzicent i mirë a din, se si ftyrë t'gjeneratës i njeh. Këta dy tjerët, Ivanin, Ivanin nuk e njëfsha. Këta kolegët shqiptar po. Ish njena që ish, domethonë, ish arsimtarja jeme e matematikës, tjetra ish shoqja jem. Domethonë, këta të Jugut, domethonë shqiptartë i njëfsha shumë mirë, po ata jo. Mirëpo, diqysh u bonëm menjihërë bashkë atje në Holandë. Diqysh unë e para menjihërë thashë arsya pse përnime kom dashtë m'u taku osht' se s'munëm na as me bashku qytetit, as....

Se atëherë as që u thirrshim maspari as në bashkim t'qytetit, se dikur u politizu, "Me bashku?" U dokke uhu {onomatope}. Mirëpo, e kështu prej takimit në Holandë i zhvillum disa ide qysh me ja bo. Edhe kur u kthym nuk shkoj shumë edhe u bonëm bashkë në zyre.

Erëmira Krasniqi: Në Jug a në Veri?

Valdete Idrizi: Në Jug, në Jug, po arsya pse në Jug osht' se atëherë KFOR-i i patën instalu domethonë krejt telat dhe ka ura, edhe një njiqind metra "zona e sigurisë" u quajt, domethonë një njiqind metra kështu rreth e rreth urës, prej ndërtesës të komunës kah... për serbt ish goxha e, goxha e sigurtë, për ata edhe quhej "zona e sigurisë". Njerëzit kush dojshin me ardhë këtu domethonë i kontrollojshin n'fillim mos ka armë, mos ka najsen tjetër, edhe ish ma e qasshme. Për neve shqiptarve edhe kur dojshim me me kërku një zonë t'sigurisë në Veri ish e pamundun, sepse ndalej ajo domethonë menjihërë, si, si mbyllej ura s'kish aty hapësirë për zonë t'sigurisë.

Përkundrazi ish ai lokali aty "Dolce Vita" që është, domethonë ata ishin, ata vëzhgusit e roje [jo], rojet e urës që veç vëzhgojshin gjithçka kush po del, e sulmojshin njerzit, i kanë rreh njerzit, i kanë kërcnu domethonë ajo me vite ka, ka vazhdu. E kështu që, e nisëm domethonë edhe CBM-in.

Erëmirë Krasniqi: Në cilin vit?

Valdete Idrizi: Në 2001-shin, n'fillim 2001-tës. Se tonë 2000-ta, na shkoj gati jin vjet t'u dashtë t'u i sjellë njerzit, me i largu [jo], me i, me i, për shembull prej Holandës grupe t'ndryshme, partnerë t'ndryshëm. Për shembull, kur thojsha, "Pse në Mitrovicë? Çka munet m'u bo?" "Po", thojsha, "Mitrovica osht', u konë qytet i kulturës, i zhvillimit e mundemi aty. Se e kena pasë, domethonë një krenari e qytetit, edhe një identitet t'fortë." E ata tani i kanë sjellë "Muzicentët pa Kufi" prej Holandës. Tani kur vijshin këtu t'njejtën kohë mriishim edhe me përkrah domethonë shkollën e muzikës me instrumente, të dorës dytë, po i mbledhshin atje.

Tani pata shku disa herë vet me fol me njerzit atje me grumbullu, domethonë me një, me nxjerrë fonde edhe instrumente me ja sjellë këtu shkollës muzikës. Edhe disa prej komunave që me mujt komunat në qeverisje t'mirë edhe krejt me bashkëpunu. Kështu që një një vjet une edhe punojsha në DRC edhe këtu deri sa e zhvillum, domethonë komplet për programin e CBM-it. Njihërë për dy vjet, tani veç ajo u

bo si institucion n'veti edhe tani organizatë. E tani, e drejtojsha komplet unë edhe pse nuk, ani pse prej fillimit faktikisht, po edhe zyrtarisht. Kështu që, ka shku, normal, ka shku kohë pak ma e madhe derisa zyrtarisht domethonë e nisëm. Po jom shumë e lumtur sepse përmes CBM-it kemi mrri përnime me punu me njerëz, me....

Erëmirë Krasniqi: Çfarë aktivitete mbështetshiti ju si, si grup multi-etnik?

Valdete Idrizi: Po fillimisht edhe grupet në, ndamas, edhe Jug edhe Veri zakonisht qysh e thashë këto kulturore, t'rive, meniherë disa, i adoptojshëm do farë shpija t'vjetra si qendër t'grave, domethonë se diqysh t'u.... Edhe gjatë luftës, edhe para luftës e kemi pa që përnime si gra gjithë jena ma t'qasshme edhe me, m'i prek temat që kanë qenë tabu edhe temat t'rana edhe kemi qenë ma t'pranushme. Shpresh kom dashtë që me investu n'gra sepse ato kanë tregu që jonë ma t'guximshme, ma t'zonjat, ma t'zëshme edhe e dishim që munën me qenë do avokatë përnime shumë t'mirë edhe n'tonë komunitetin. Kemi fillu njiherë ndamas me t'ri, tani edhe me një grup t'pensionistëve, varësisht kërkesat vishin tani prej, prej njerëzve.

E di që patëm bo bum {onomatope} një koncert shumë t'madh në, në stadium në Mitrovicë, edhe e kemi bo t'njejtën kohë edhe n'qendër atje se s'kanë stadium ne Veri, e patëm bo jashtë një koncert. Sikur njëfarë, ani pse kish disa muj si, si CBM që kishim fillu, po thjeshtë me bo njëfarë, njëfarë promovimi t'organizatës, me dhonë njëfarë domethonë njëfarë bumi përnime. Edhe rezultoi t'jetë hap shumë i mirë sepse veç njerëzit u njofshin, edhe për qytetin domethonë u njoft CBM-i edhe që osht' me ekip t'përzim. Se edhe këtu tregojshim që në Veri po mbahet një aktivitet, edhe këtu, për gjithçka mendoj, i njoftojshim edhe këtu edhe shpresojshim që hapi tjetër këto grupe kanë m'u bo bashkë. Që n'fakt u bonën masnej.

Dikur bashkë me, me komunitetin me njerëzit ja nisshim masnej m'i zhvillu idetë, jo veç që vijshin e m'i përkrahë, po bashkarisht. Dikur edhe nismat na që i kishim t'u shku bashkë, t'u na dëgju bashkë t'u fol, t'u na dëgju bashkë kanjihere edhe t'u diskutu edhe për gjana që s'pajtoheshim, se kish shumë na që s'u pajtojshim si serb e shqiptar. Edhe po menoj njonën anë diskutojshim....

Erëmirë Krasniqi: A kishit konflikt, po menoj a kishit situata që ishte ashtu bash e vështirë m'u pajtu?

Valdete Idrizi: Po, po, po. Kemi pasë domethonë kena pasë n'mënyrë të vazhdushme. Kur dojshim me fol për historinë për shembull, na ndryshe kishim mësu për historinë tonë edhe e dishim atë, sidomos atë historinë personale që e kishim përjetu, e për serbët për shembull, ish krejt tjetër, krejt tjetër histori, tjetër përvojë. Edhe nuk dojshin n'fillim as me pranu, edhe na s'dojshim me pranu që ata qashtu e kanë përjetu. Përnime është dashtë shumë kohë për, deri sa e kena fitu faktikisht besimin e njoni-tjetrit edhe derisa thjeshtë u mësum me respektu edhe ndjenjën e tjetrit.

Qoftë me u frigu prej shqiptarëve ose prej serbve, qoftë ajo ndjenjën e pasigurisë ç'a po pranon a ç'a s'po pranon apo qysh po identifikohesh. Me, me kohë domethonë fillum thjeshtë me respektu, megjithatë a din qenie njerëzore edhe ki drejtë me u frigu ose mos me u deklarë për këte ose ate se e kem një pasojë. Kështu që, u msum faktikisht me rujt kolegu njoni-tjetrit edhe për me, për me bisedu edhe për tema. Për shembull, edhe gjatë luftës kur, kur, une për shembull i thojsha koleges, "Qysh ti, s'munesh, s'po munesh me, s'e ke ditë faktikisht," thojsha, "që une si studente kurrë s'kom mujt me hy n'fakultet?"

Thojsha, “Qysh?” A pe din, s’ma kapke truni qysh dikush i gjeneratës teme në Veri mos me ditë që une jom konë e përjashtime veç pse jom konë shqiptare, prej sistemit, edhe që une gjithë jom tutë me majt libra se t’hishin profesorat [në burg]. Domethonë, kur i tregojsha sa herë kanë hy n’klasë i kanë rreh profesortë, kolegtë, studentat e krejt, “Ja ja, s’osht’, diqysh s’osht’ e mundur.” E thojke, “Nuk e kom ditë.” Për mu përnime ish shumë e pakapshme me, me i besu, deri dikur përnime, edhe ma vonë thjeshtë i besova se s’osht’, kushtimisht po thom, nuk osht’ mërzitë edhe e ka pasë jetën e vet.

Veç prej qasaj perspektivës, a din, edhe u nijke edhe keq vet. Thojke, “Mu shumë po m’vjen keq se po t’besoj. Edhe unë e kom pasë t’vshtirë me t’besu që përnime e ke përjetu qata.” Thojke, “Po te na, qoftë media, qoftë diç, tjetër çka na u ka servu. Edhe na si serb kena menu që ju si shqiptar veç po doni me bo diçka tjetër edhe për qata po ju përjashtojnë, ose e keni, e keni meritë.” Kemi fol bashkë për kësi pervoja personale. Për shembull, edhe kjo mos-lejimi i kthimit në Veri në pronë tane, kjo gjithë ka qenë temë n’tavolinë.

Erëmirë Krasniqi: Qysh e komentojshin ata qët’ pjesë, qysh e, qysh i jepshin kuptim qesaj situatë?

Valdete Idrizi: Po n’formë t’ndryshme. Në një rënë anë edhe ata u nijshin keq, po meno, se duhet gjithkush me pasë drejtë m’u kthy. Në tjetrën anë e kishim, dikush e kish ose farefisn e vet, dikon prej farefisn që s’mujke m’u kthy, thojke e njejt, e njejt gja. Dikur thojshim megjithatë osht’ realitet tjetër, mos lyp m’u kthy se shancë nuk ka. Osht’ t’u bo secilën herë ma keq, ajo ndamja osht’ t’u u bo pak ma e madhe. Në tjetrën anë thojsh çka mujm me bo na si individ, ose si aktivist, ose si organizatë? Diqysh...

Erëmirë Krasniqi: A kanë pasë frikë edhe prej komunitet t’vet?

Valdete Idrizi: Po, absolutisht. Edhe kanë qenë disa herë të nalun, t’intervistum prej atyne rojave t’urës, “Ça po boni n’Ve... në Jug? Me kend po punoni?” Ka pasë raste kur osht’ dashtë t’rrinë veç në Veri edhe normal, unë kur po them u mësova m’i respektu edhe frigën po edhe vendimin që disa ditë me u, me nejt veç atje, sepse megjithatë jeta osht’ e shenjtë, e kisha provu vet. E di qysh, domethonë qysh osht’ me t’kërcnu, me t’sulmu, me provu me t’vra. E kështu që nuk ka qenë e lehtë aspak.

T’njejtën anë edhe prej Jugut për shembull kish njerëz, plagët e hapuna prej luftës, atëherë sado pak që mundeshim, une i kisha edhe disa domethonë edhe n’familje që i kishin vra gjatë luftës. Edhe u themelu ni shoqatë “Kujtimi”, Fondacioni “Kujtimi” që me, mledhshin familje që i kishin hup njerzit gjatë luftës. Do i kishin gjetë, do s’i kishin gjetë, i kërkonin. E kur vishin n’zyre e dëgjojshin t’u fol serbisht edhe ajo ish, domethonë ish një, një sfidë tjetër, domethonë m’i tregu që për me dashtë me ecë përpara duhet me punu bashkë.

E për ta që plagën qaq t’hapun, ish vështirë domethonë e pranushme. Kështu që, ka qenë përnime shumë e ranë me punu me dy anët, edhe me Jug edhe Veri. Po, jena konë diqysh të singertë. Une shpesh i kom thonë, “A ka faj ky ose ajo, ose ajo? A munem na krejt tash m’i fajsu? Për me dashtë me lyp një drejtësi për to duhet me punu bashkë.” Edhe për me dashtë përnime me shku atje s’muj pa fol me atë tjetrin se edhe ai e ka hup një pronë në Jug. T’u sjellë diqysh raste specifike ose individuale, t’u i tregu me emën e me mbiemën, se megjithatë qyteti nuk osht’ i madh edhe njihen familjet, domethonë kush i kujt osht’, ose çka kanë bo, ose çka s’kanë bo gjatë luftës... se kështu, domethonë, atëhere menjihere mas luftës, “Hë i kujna osht’? A jonë konë t’përfshim, a s’jonë konë?”

Kështu u ngjifshin, domethonë edhe familjet edhe lagjet edhe krejt në Jug edhe në Veri. Mirëpo t'u, diqysh t'u qenë besnik ndaj veç edhe parimeve tua edhe misionit t'organizatës, që përnime ish mision shumë, hala menoj që osht' shumë i shenjtë për me, për me bashku qytetin, me, me i bashku njerëzit. Edhe tani, tash për me bashku misioni s'është arritë hala po s'paku me qëndru ende si urë-lidhëse mes njerëzve. Sepse krejt u pajtojshim që qyteti kështu nuk munët me metë, i ndamë etnikisht, po duhet me qenë i integrum kur krejt qytetarët, thjeshtë, me jetu normal si çdo qytet tjetër.

Pjesa e Katërt

[Folësja tregon për shkuarjen e saj në pjesën veriore të qytetit të Mitrovicës]

Valdete Idrizi:... kjo ish pak ma herët, domethonë 2001-ta, masi veç e kishim nisë në CBM *[Community Building Mitrovica]* punën. Edhe pata provu, edhe ata m'kanë thonë, "Jo, për shkaqe të sigurisë nuk munem me t'çu edhe ti s'guxon me shku n'banesë". Edhe, po megjithatë thashë, "Hajt po rrezikoj, diqysh del ku t'del", edhe s'menova, se me konë menu pak ma mirë garant s'isha shku.

Edhe u nisëm me motrën, hajde, edhe e murrëm ni çantë t'zezë, kështu bajagi e madhe se thamë te mushëm sene ça t'munemi me marrë me i marrë këtu, se kur na kishin qitë atëherë kurgjo s'patëm mrrri me marrë. E shkum te, domethonë para banesës tonë. Paj prej urës kryesore as pesë minuta nuk bonëm se ecën shpejtë për me shku te banesa. Edhe ashtu nuk osht' shumë larg. Kur mrrijtëm para banese po dojmë me hy n'atë... se dikush na kish thonë n'fakt, dikush na kish thonë që qatëherë ishin dalë grupe, që kanë shku, osht' e zbrazt. Qajo neve pak, a din, mu faktikisht ma dha një shtytje që hajde t'shkoj te provoj nashta u metë diçka.

Edhe kur shkum para banesës ajo derë gjithë ka qenë e hapun. Domethonë pesë, ndërtesa e madhe domethonë pesë katshe, na n'tretin kat kem jetu. Ajo ish konë e mbyllun me dry, që kurrë s'e kisha përjetu najherë se kurrë s'u konë e mbyllun përpara. Edhe po hy une aty në supermarket poshtë. Ish një ko... ish njëfarë kojshike domethonë, Zorica emnin. Po hy edhe p'i thom në serbisht, thashë, "A e ki çelësin", thashë, "se po du me shku n'banesë?" Ajo veç i ka hap sytë, m'ka thonë, "Edhe me pasë" tha, "nuk guxoj me ta dhonë". Tha, "Ma mirë shko". Une {tregon me fytyrë si e habitur}, a din? Thashë çka ka. Edhe, n'rregull.

Motra ndërkohë po shkon mas banesës me thirrë një kojshi i cili kish punu në DRC *[Danish Refugee Council]* ma herët. Une e kisha lonë DRC-në po e mora për çdo rast njëfarë, atë...

Erëmirë Krasniqi: Bexhin?

Valdete Idrizi: ... atë bexhin, se bexhat t'pshtojshin, "Me këta t'hujt" e kishe njëfarë sigurie deri dikun, a imunitet a ça mi thanë. Une e mora. Ai ish i skadum se isha dalë une prej DRC-së po hajt thashë te maj me veti për me pshtu. Edhe t'u, t'u e ditë që qai kojshia veç punon atje p'e thirri, motra jem shkoi mrapa për me thirrë, une rrisha para banese ndërkohë mos po del dikush. Edhe tash ndërkohë dikush veç m'kish pa, une s'e kom pa hiç, edhe jom konë domethonë përpara kerreve qysh jonë [të parkume].

S'di as vet, a din, po diqysh gjithë kom fat, s'di as vet qysh jom largu, kur veç kur e kom pa para komve një vazo e madhe. Prej atje terase, n'pestin kat, domethonë kur e ka gju dikush edhe bërtitke, shajke serbisht. Kur e [shikoj lart] qaty e kom pa që e kish me mu. Veç jom largu. E di që kpuat krejt m'u prishën, se prej atyne, se ajo e dheut ajo vazo e madhe. Që parameno ajo ish, me m'konë ra unë isha

metë qaty. E tash une diqysh si në shok e ça u bo? Edhe bërtitsha po menoja pa e kontrollu vetën, “Çka keni?” Kur masnej, dej sa ka ardhë motra, domethonë se ajo s’ka ndi hiç se mas banesës t’u thirr me zo t’madh, t’u e thirr atë kojshin për m’i ja çel derën....

Veç kanë zbrit qaq shpejtë gjashtë gra, jonë konë krejt t’zeza veshun, e t’më kanë sulmu. Une as s’kom ndi dhimtë prej tutës, as, prej, a din as... çfarë momenti u konë... veç e di që kur jom kthy jom konë e përgjakun krejt mo. Nji kohë t’gjatë s’më kanë, domethonë osht’ dashtë nji kohë e gjatë krejt me m’u shnosh, domethonë ato plagë që veç...

Erëmirë Krasniqi: Çka ish arsya që ishin, që ju sulmun?

Valdete Idrizi: Ata...

Erëmirë Krasniqi: Çfarë arsytimi?

Valdete Idrizi: ... maspari mthojshin, “*Marš u Albaniju!*” domethonë, “Shko në Shqipëri!” “Ça ke lyp këtu? A je ardhë me na kërcnu a?” Se e dishin se nana jem disa herë kishte provu me shku. Kur kanë shku me, n’banesë me kërcnu edhe ato, kjo ju ka thonë, “Ja u gjuj bombën”. Çfarë bombe, po me i, domethonë me u.... Edhe tash këta e kanë marrë si kërcnim. Edhe njihere ti po shkon, plus e dishin vllaun që e kom pasë n’luftë, a din!

Edhe ishin konë me t’zeza veshun. Sigurisht i kanë pasë ose t’pagjetun ose, a din, t’mytun dikon gjatë luftës se.... Edhe kur... edhe njena prej tyne ishte ish-kojshikja jeme me to, edhe e di që m’shtrejtën për kerri edhe sa mujtën me m’mshu mu. Qaty e kom pa që i kom pa dy ushtarë, franqez, dy ushtarë t’ri t’u kalu edhe une kur kom bërtitë “*Help!*” [ndihmë], veç m’kanë kqyr edhe e kanë kthy kryt edhe kanë shku. Ajo u konë për mu noshta, qajo u konë ma shumë zhgënjim, për shembull, se njerzt me armë që jonë aty, se hajt për paqe me t’ikë, a din? Po ata diqysh sikur tutën për veti.

Thojsha, “Hhajt t’isha kon naj burrë, a e armatost a, naj, a din kështu që paraqes naj rrezik, po thojsha hej te ha dreqi nji gru”! Edhe a din, diqysh mos me ardhë e mos me intervenu, diqysh kjo ke njifarë... diqysh këtë.... S’po di nji zhgënjim fort t’madh e pata pësu. Se a din qysh? Tek ma vonë unë i kom ndi dhimtë, se hiç, hiç, n’atë moment s’kom ndi kurfarë dhimte. Veç e di që ça m’ka pshtu, m’ka pshtu qaj bexh. Se kur u ardhë qajo kojshikja ndërkohë që kish thirrë motra, kur ka ardhë qajo kojshikja edhe bexhi me m’shpëtu i kom thonë, “Hajt se kom me ta qitë Vucën pi pune”, djalin i kom thonë.

Me këtë, a din? Kush isha une, unë e kisha lonë atë punë. Po s’disha ça m’i thonë diqysh për me, për me pshtu. Edhe ajo tash i largoj ato gratë. Ndërkohë kur erdh motra u shashtrisë kur m’ka pa, se s’e kish pa. Po, n’rastin tem tash mes dy banesave jonë do kojshi tjerë shqiptarë që kanë metë atje deri vonë. Tani ma vonë edhe ata i bonën presion e i qitën. Ata plus i kishin edhe dy, ajo shoqja jeme i kish dy vllazën domethonë t’zhdukun që ja kishin vra gjatë luftës. Domethonë, kish metë me nanën e me babën aty. E ata tani kanë ndi britmën teme edhe kur m’kanë sulmu, domethonë e kishin thirrë këta KFOR-in, a gjandarmërinë n’fakt, edhe për me ardhë me më, me na, domethonë me na nxirrë pi banesës.

Po tani u ngjitëm na n’banesë. Mrrijtëm diçka me marrë, po s’di as ça kom marrë se... as ça ka pasë, as ça kom pasë, se domethonë u tutëm. Motra u pshtetke për dere, dejsa nashta vjen dikush me na pshtu, edhe ose nashta qetësohet tani me ikë. Une u munojsa diçka me marrë, e s’di...

Erëmirë Krasniqi: A ish metë najçka? A ish hala...

Valdete Idrizi: Krejt ishin kështu... po ishin diçka do libra, do albuma, do ashtu. Diçka mora, po s'kom mujt me, s'mujsha me zgjedhë çka. S'i patëm pesë-gjashtë minuta. Plus erdh qajo kojshika, "Hajde mos tutni, se kërkush kurgjo nuk ju bon. Qitash ju vijnë". Tani jonë ardhë, na kanë pasë nxjerrë këta, KFOR-i, edhe u patëm kthy. Veç e di që kur ka dashtë një gazetar me m'intervistë s'kom pasë pranë hiç. S'ma kapke truni qysh gruja ma s'pari munet m'u konë e dhunshme. Se diqysh une, e thashë ma herët, kom besu gjithë n'grunë a din, edhe gruja e arma s'kom besu kurrë që shkojnë, a din dhuna.

Ke shumë njëfarë... tjetren anë e kisha këtë farë zhgënjimin n'forcat paqërujtëse. M'bike tani n'men Srebrenica, e shumë, shumë sene tjera. Qysh po funksionojke truni n'ato situata. Edhe e di që pata nejt n'shpi edhe pata, një javë me njëfarë shalli në fyt mos me u dukë. Edhe kom pasë, s'di as vetë pse e kom zgjedh qashtu veç me mbyll qat' histori mos me fol.

Erëmirë Krasniqi: A njëshit përgjegjësi mos m'i zhgënjy edhe tjetër, apo qysh?

Valdete Idrizi: Noshta, noshta, sepse nuk dojsa as me pranë faktikisht, nuk disha as me pranë. Edhe e di që n'shpi ju kom thanë, "Hajt u kry, pshtova. Qikjo osht' me randësi". Edhe e di që kom thonë "Shyqyr", thashë, "edhe këtë here", se përnime kur m'bike n'men që ka mujt n'kry me t'ra me t'lonë n'ven. E qajo u konë një, një situatë për një kohë, hiç, hiç s'pata... e dishin edhe në organizatë krejt çka ka ndodhë, po une pata zgjedhë mos me, hiç mos me fol. Edhe, e dijsin domethonë e respektunë edhe tjetër. Edhe s'dashta me nejt n'shpi me u mbyllë, po me ardhë edhe me u shtirë kishë kurgjo, ani pse shumë vështirë u konë me u shtirë po, s'paku qikjo mu m'ka mundësu për, thjeshtë për me vazhdu punën.

Edhe diqysh i jam falenderuse qasaj energjie, se di çka m'ka shty me bo një vendim t'tillë, se noshta e kisha, e kisha mbyllë qaty. Edhe punën, edhe organizatën edhe ku me ditë çka kisha bo diçka tjetër, ose s'kisha bo. Po, jam falenderuse qasaj energjisë ose qasaj shtytjes që m'ka bo për, për me marrë një vendim t'tillë.

Erëmirë Krasniqi: A ka pasë këtu familje t'përzime para, para luftës?

Valdete Idrizi: Pak.

Erëmirë Krasniqi: Pak?

Valdete Idrizi: Te na ka pasë shumë pak. Jonë njoft n'gishta, a din? Nuk ka pasë shumë. Për shembull, ka pasë boshnjak me serb që jonë konë domethonë t'martum. Tani metën dikush knej, dikush andej. Po shumë pak ka pasë. I kemi njoftë kur thojnë n'gishta ato familje. S'ka pasë shumë t'përzime. As martesë, po edhe nuk... qysh me thonë, ma herët kanë qenë t'ndame edhe shoqërimi, edhe nëpër lokale, me krejt pak ma herët. Jo, domethonë jo veç n'atë kohë po veç një dekadë përpara, a ma shumë që veç u nda.

E tani t'u e pasë une qët' përvojë, tri vjet ma përpara, 2004-shi prapë thojsha s'kom qare pa bo diçka me punu me kolegë, e me u kthy te ajo, te ajo plani B edhe C. Tani e disha që shkojshin, këtu prej ure disa herë n'ditje shkojke një, një ksi kombi-bus që i çojke njerëzit që kishin punë në Gjykatë. Shqiptar a, rom a, boshnjak a, krejt komunitetet që jetojshin në Jug i çojke atje ose anasjelltas. E, e shfytzojshin njerëzit. Shkova te ata. Ishin ato, nëse s'gaboj policia e Pakistanit, a Indisë. Edhe i luta edhe ata, ja

shkruva një letër, thashë jom kështu, kështu, kështu. “No, no, no, no” [Jo, jo, jo, jo]. Veç nëse ke dokumentin e gjyqit me ato t’pranojshin me hypë.

Tani e kisha çikën e axhës që punojke n’gjyq. Si krejt shqiptart edhe une n’t’zezën diçka me bo, edhe sidomos kur s’ki qare. Edhe i thashë “a munesh me ma bo ni, ni kërkesë kishë kom punë n’gjyq se po du me pas një takim me staf atje?” “Ani”. E bona qat’ letër edhe tetë muj rresht une e kom fallcifiku qat’ letër tu ja ndrru datën. Edhe veç ja ndrojsja edhe u bona kogja nifar eksperte kështu n’fallcifikim, edhe e qitsha n’kese t’plastikës se thojsha m’prishet. A din, se thojsha ka mem’ vyjt hala. Po aq, secilën herë që jom hi u tutsha që po m’nxojnë.

Veç ja bojsha kështu {ilustron si e ka tregu dokumentin} edhe e mshefsha a din, që kom sot takim. Edhe u konë periudhë shumë, shumë e ranë se ani pse dikush e dike që s’kom punë. U konë vështirë se përnime sa herë t’shkojsh maspari mos po t’nxojnë. Kaniherë t’shihshin që ti po shkon pak ma shpesh. Kur ndrojsja vozitësi kisha qef sepse ai mendojke që s’më ka pa që një javë, a dy. Po që t’pajke tri here n’javë u konë goxha zor. Edhe t’njejtën anë ajo farë veprimi me fallcifiku dokument shumë e ronë a, si ndjenjë. Diqysh, qikjo veç t’kallxon çfarë përkrahje kena pasë përnime prej organizatave që kishin mujt pa asni problem, me më, me më çu.

Se ata shkojshin, i takojsha t’njejtë njerz, domethonë qatje. Se na n’ndërtesë ku e patëm na zyrën, disa organizata e kishin zyret edhe më shihshin. Edhe e dishin që unë diqysh jom ardhë. A din qata t’njejtë që m’kishin refuzu edhe s’dojshin. Kanihere e kom pasë problem m’u kthy se ose s’kish ven në kombi-bus, i fundit ish n’tre e pesëmbëdhjetë nëse s’gabo, kur u mbyllke gjykata, edhe metsha. U duhke me prit deri sa u bojke natë që mos me m’pa dikush ka kaloj, se a din me t’sulmu a me t’rreh a diçka. Edhe njoni prej kolegëve m’përcillke deri te mahalla e Boshnjakëve, te ajo ura tjetër pak ma rahat. Edhe, u konë periudhë, një pi periudhave ma t’vështira.

Se knena bojshim një punë t’mirë, i zhvillojshim do ide, knena okej ish ajo ernalgjia që munëm m’u kthy edhe njihere, besimi që mujm me bo si organizatë. Edhe në tjetrën anë ajo frika konstante që ti ke bo diçka jo legale. Tani frika që po t’gjonë diçka prapë. Edhe u konë shumë, shumë e vështirë për me, për m’u kthy edhe njihere si staf, si organizatë. Tani mas tetë mujve u kthym, ose ma pak nëse s’gabo se n’prill, edhe n’fund t’tetorit jena bo, jena bo bashkë si organizatë përsëri.

Ja nisën me u liru pak, ato telat u ngushtun pak, edhe u, thjeshtë u mundësu kjo. Po e di që mos t’kisha qenë atje, mos t’kisha qët’, qët’ fallcifikimin ose rrugëtimin e tmerrshëm e di që ish konë e pamundun ose shumë e vështirë me i kthy edhe kolgët për me ardhë këtu. E tani rujtjen e partneritetit rrjedhimisht që kishim kriju edhe me, me njerzit e Veriut t’gjitha komuniteteve, sepse atje jetojshin n’lagje të përbashkta. Edhe shqiptar që kanë mbet domethonë tanë kohën edhe gjatë luftës edhe mbas luftës, kish disa që në mënyrë graduale ishin kthy, domethonë individualisht nëpër shpi t’veta, edhe domethonë me komunitete tjera.

Domethonë veç i kishëm... qikjo osht’ ajo, qajo përgjegjësia e besimit tyne që e kishin n’neve si organizatë. Domethonë përgjegjësia ka qenë shtytësi ma i madh për neve, domethonë edhe për m’u si udhëheqëse e një organizate me jau jep një shpresë edhe kur vet pak e kisha atë shpresë.

Erëmira Krasniqi: Serbët e Veriut, a u merrshin edhe ata me komunitete apo...

Valdete Idrizi: Po.

Erëmira Krasniqi: ... apo veç me serb?

Valdete Idrizi: Po, po, jo, na ishin si, si ekip bashkë...

Erëmira Krasniqi: Projekti domethonë...

Valdete Idrizi:... ku shkojshim bashkë si ekip. Edhe pse edhe këtu kur shkojshim ose nëpër enklava, ose që n'lagjen e në "Kodrën e Minatorëve" që jonë t'përzimë, bashkë na shkojshim edhe te shqiptartë edhe te serbtë. Edhe nuk, se përnime folshim me një gjuhë... ne, na e kishim një mision. S'ish tash ata.... Kanihere për shembull ata e vlerësojshin që duhet veç serbtë me shku, unë i besojsha, shkojshin veç ata sa t'u zbutke situata. Ose kështu, t'njetën kohë e kishim zhvillu për shembull programet e t'rive që ta jepshin njëfarë motivi për punë. Edhe "Rock Shkolla" që veç ja kish nisë. Hala zyrtarisht nuk u, nuk u themelu si shkollë po ish si projekt në veti. Këna i shihshim talentat.

I shihshim kanihere nxansat tinza shkojshin te një-tjetri e u tutshim edhe për siguri t'tyne. Po ish shumë inkurajuse domethonë ajo farë bashkëpunimi i tyne. Edhe tani ata shërbejshin si shembull edhe me ja ndërru qëndrimet e prindve, që zakonisht ndodhë e kundërta. Te na në Mitrovicë përnime shpesh ka ndodhë që fmiya ose nxansat me shërby si shembull për msimdhansa ose për, për prind, po.

Erëmirë Krasniqi: E ku ish "Shkolla e Rockut", në Veri apo në Jug?

Valdete Idrizi: Dy. Atje s'kemi mujt se fmi. Ka qenë domethonë, edhe ka qenë vendim i përbashkët që nuk guxojmë me nisë një, se fmi jonë. Me rreziku domethonë jetën e tyne, ajo osht' e pamundun. Po tani me këtë botën e internetit, e teknologjisë e, ata veç ja nisën m'i bo do grupe t'përbashkta edhe do, njëfarë, njëfarë webfaqe ku shkrujshin përvojat e tyne. I lexojshin tjetër. Edhe tani në, në shkollën verore që organizojshim këta i bojshin edhe bendet e përbashkta, kangët besa t'përbashkta që i knojshin. Kështu që, ajo ka qenë përnime edhe një motivim shumë ma i madh edhe për neve me bo.

Për shembull, prindtëfillimisht nuk na lejshin. Na pytshin kur dojshim me marrë lejen e tyne, se edhe me shkrim duhej kur dojshim me lshu venin për shembull me shku në Maqedoni, ata shkrujshin edhe thojshin... na u deshke pëlqimi i tyne se n'kufi s'na lejshin... "Jo". Për shembull, "Çfarë muzike keni me ngu deri në Shkup?" "Me konë ulet vajza jem edhe djali jem?" Domethonë, shumë, shumë osht' dashtë me punu me, jo me javë, po me muj të tanë me i bindë ata me i leju. Për shembull, vitin tjetër, n'bazë qityne përvojave t'mira, vetë prindtë lypshin, "A ka mundësi me na siguru ju transportin bashkë?"

Se n'bazë nxansave qysh jonë shoqnu tani edhe qëta t'njejtit prind që kishin këto pyetje t'vështira, që s'dojshin me i leju. Sidomos prej serbëve kena pasë ma shumë se prej shqiptarve, sepse, "Po i bini ka shqiptartë këna për me shku anej". E tani u konë inkurajuse kur i shihshim. Domethonë, s'kish mo, thjeshtë një [grup] talenta fmi që e kultivojshin muzikën e mirë. Në të njejtën kohë e nisëm një projekt me gazetën, magazinën që shkrujshim për Jug edhe në Veri. Për shembull, çka funksionon këtu e çka s'funksionon atje? E nxitke njëfarë dialogu edhe bashkëpunimi. Marrshum ksi përgjigje, *feedback* [reagime] tyllifare prej njerzve në Jug e në Veri.

Faqja që ma s'shumti ka qenë e klikume, e interesume osht', e kemi pasë një si lloj kuizi me fotografi t'vjetra të Mitrovicës, kur osht' bo edhe n'cilin ven? E tani ishin do farë, modeste, do farë shpërblimesh. Jo, darkë n'këtë lokal, ose n'atë lokal, qoftë në Veri edhe në Jug. Kajhere votojke shqiptari me shku në Veri, ose.... Shumë, ka qenë njo prej projekteve ma t'mira që shumë e kom

dashtë. Kishim edhe kërcënuse. Kur shkruajshim për xhaminë domethonë që ka qenë menihere mas urës, domethonë që ishte identifikimi Mitrovica me urë, mullini edhe xhamija, për shembull thojshin, “A po doni me kthi a?” Edhe njerzit përnime edhe kur lypshim me kthi se ka qenë njo prej simboleve që thjeshtë e ka simbolizuar Mitrovicë.

Erëmirë Krasniqi: E kanë rrxu apo çka ka ndodhë?

Valdete Idrizi: Po, fatkeqsisht e kanë bo.... Faktikisht tash as s’dihen gjurmtë e saj hiç, hiç që ka ekzistuar. Deri ’99-tën domethonë aty ka qenë. Xhamija s’i ka penguar kërkujt. Tani u... komplet për tokë. Edhe e kanë fshi domethonë atë gjurmë t’xhamisë që ka ekzistuar najherë, se tash osht’ gati si osht’ betonu ajo pjesa. Edhe plus me këtë projektin e Bashkimit Evropian tash, domethonë nuk shihet hiç, hiç. E, kishim edhe kësi lloj kërcënime kur shkruajshim për Mitrovicën edhe n’qatë kohë para ’99-tës. Po, në të njëjtën anë edhe t’u pa që po hecim, po kena sukses ose sa ma shumë diqysh t’u çelshin do farë urash mes njerzve, ta jepke ty një motivim t’madh. Në të njëjtën kohë bllokada sa ma shumë prej, a din, vendim-marrësve, thjeshtë nuk ndihmojshin. Ka qenë goxha vështirë, po....

Erëmirë Krasniqi: Ky njëfarë projekti për me kriju njëfarë imagjinate t’përbashkët të qytetit?

Valdete Idrizi: Po, po absolutisht. Thjeshtë njii... se dhem shumë kur qyteti jot, diqysh që e ke rritë me njëfarë lloj krenarie, një qytet që i ka promovuar edhe i ka përfaqësuar vlerat e diversitetit, që osht’ njoft gjithandej diqysh me qët’, me qët’ imazh, ti tash, ishe një qytet i problemeve, qytet i ndamjeve, qytet i vrasjeve. Diqysh edhe kur, kur shkojsh n’qytete tjera, “Prej kahit je?” “Prej Mitrovicës” Ose thojshin “Ufff” {rrudhë fytyrën}. Domethonë, si me t’kqyr si gjynah. Ose, “Huh, Mitrovica, sherri juve metëm si Kosovë gjithë me probleme”. E të dhimke ky farë lloj imazhi që ju kish kriju qytetit. E jo ai....

Na thojshim nashta me kthi edhe njëherë qat’ imazh. Edhe gjithë t’u bashkëpunuar. Domethonë, kjo edhe kontribon në ndërtimin e paqes n’qytet, edhe t’pajtimin, edhe të, të domethonë t’normalitetit. Po thojshim me ngritë imazhin. Kish njerëz që thojshin, “A po doni me kthi ju Jugosllavinë a? Jugo-nostalgjikë.” E kish, domethonë, po as që u mërzitshim. Se sikur t’ishim mërzitë pej atyne reagimeve, s’kishim bo çka kishim mujt me bo.

Erëmirë Krasniqi: A mendojshit ju që t’u e rritë komunikimin ju në njëfarë mënyre edhe po ktheheni?

Valdete Idrizi: Po, ajo osht’... gjithmonë ka qenë domethonë misioni jem, edhe i jemi personal domethonë edhe i krejt kolegëve. Se thojshim sa ma shumë që t’hapen dyrtë ma lehtë na mundësohet, po. A po beson shkojsh në Veri edhe kur s’kisha punë hiç? Veç diqysh s’dojsh, s’dojsh m’u lodhë prej pritjes. Thojsh, “Hajt, hajt!” Domethonë, edhe thojsh nëse edhe une nuk shkoj, domethonë kërkush s’po shkon. Këto institucionet edhe ashtu s’guxojshin me shku. S’e marrshin domethonë qat’ guxim me nisë ose naj nismë kështu me shku.

Bile as me na përkrahë t’shumtën e rasteve. Edhe shkojsh. Kajherë kur thojnë veç u, veç një diçka t’shkoj në Veri, u kthejsh ka një, një xhiro atje edhe u kthejsh. Thojsh edhe ata le t’msohen, le t’më shohin që shkoj une edhe s’nalem. Tani i kisha edhe varrezat. I kisha vorrin e babës edhe t’vllaut atje. Ka qenë e dhimshme se ka qenë një kohë kur s’kom mujt as me shku, se s’lashin atje, gujshin me gurë. Ose, ose nëse e gjejsh dikën kështu prej miqve ndërkombarë me m’çu deri atje. Si shkojsh dej atje, atje diheshin që jonë varrezat e shqiptarve edhe duhej veç një minut, ose gjysë minuti edhe me nga shpejtë. Tani i kanë shkatërruar disa herë. Copat, bile kolegja jeme serbe, mi ka pasë pru copat mrena

n'zyre. Bile u pat' tmerru qysh osht' e mundun, a din, pse emën shqiptar edhe.... Shumë e dhimbshme kjo, kjo se...

Erëmirë Krasniqi: A ka ekzistuar një formë e organizime t'vizitimit t'varrezave t'shqiptarëve?

Valdete Idrizi: Po, për Bajram, po. Për Bajram organizojke Bashkësia Islame këtu me autobusa. Edhe u konë njëfarë si lloj marrëveshje e pashkrume, nuk ngucshin as serbtë për Bajram se e dishin osht' një festë. Po, aty për shembull autobusi u ndalke atje poshtë. Nëse dikush i ka varrezat nalt, ti dej sa mrrishe me shku ku i, qysh i kom pasë une varrezat e babës e vllaut, dej sa shkojshim atje ish koha kur autobusi kthehej, a din, edhe s'kishe kohë. Kush i kish ma afër, domethonë kisha ma, kish ma shumë kohë. Po ti tash kanihere kishe nevojë veç vetë me shku edhe jo ashtu me presion t'shpejtë ose jo veç me pru do lule, po me nejt kanihere, me, ose me mjellë një lule me pastru qysh duhet.

Edhe u konë shumë e dhimbshme diqysh as qata mos me mujt me bo. Kena, edhe n'këtë drejtim kena pasë provu me bo diçka. Nja, me vite të tana t'u komunikua me krejt aktet që janë kyç, prej Komunës, dy, tri, Komuna në Veri se s'dishe ku me shku... e UNMIK-ut [*United Nations Mission in Kosovo*], kjo paralele tani kjo Zyra Administrative. Domethonë te të tre u duhshe ti me pasë, a din, njëfarë lloj hajt leje ose pajtimi që m'i leju shqiptarët me shku m'i pastru m'i rregullu ato që janë prishë, e mos m'i nguc kërkush. Ose edhe serbtë me ardhë këtu, se edhe këtu i demolunë do, goxha do i shkatërrunë të serbëve.

E tani taman ti i kishe, që thojnë, te tanë njëfarë lloj pajtimi, koncensusi, a din kështu, dilke një, qysh ka ndodhë te na, një këshilltar i një kryetari ose kryeministri me një deklaratë bombastike, e bojke t'kundërtën. Ty t'kthejke mrapa. Për shëmbull, kur e kena pa, serbtë lypshin, ka qenë kusht i tyne na serbtë dojna m'i pastru varrezat, s'dojmë shqiptarët. Edhe shqiptarët njëjtë. Edhe veç kur e kena pa një mëngjes një vendim prej dikuj nalt të Jugut edhe veç ja kishin nisë shqiptarët me ja pastru varrezat serbëve, krejt t'kundërtën ça e lypshin. Tani çfarë...

Erëmirë Krasniqi: Ama serbtë e kanë pasë në Jug [varrezat]?

Valdete Idrizi: Po. E tani çfarë, çfarë problemi kena pasë na si organizatë. Le që s'besojshin, kolegja jem tham "M'fal s'muj me ardhë as n'punë." Qaq që, mesazhe t'u thonë na keni rrejt. Tani e deshke me shkru njëfarë konference, kësi komunikatë për shtyp që kjo s'osht' aktivitet i jonë, na kemi mendu kështu t'u i respektu, a din, krejt komunitetet. Po ti e din ajo e para kur osht' ni bum tani osht' shumë e vështirë me, po. Kjo osht' veç një prej shembujve, damet që i kanë bo veprimet të pamatshme, t'gutshme, a t'qëllimshme, këta s'e kom, s'e di kurrë. Po e kanë, e kanë vështirsu thjeshtë punën tonë për me, për me vazhdu edhe për me bo.

Tani shumë projekte t'mira që tash janë organizata, sot funksionojnë. Për shembull, "Rock Shkolla" po funksionon si organizatë n'veti. Domethonë, une tash veç knaqem kur t'i shoh a n'televizor dikah, a n'koncert apo... domethonë, besa edhe kur i kom pa t'u shku njëfarë, njëfarë turneje nëpër Evropë se kanë fitu domethonë. Janë votu, kanë fitu disa çmime. Kur p'i shoh, zemra mal po t'bohët, a din, t'u e ditë çfarë rrugëtimi sa vështirë u konë. Ose "Qendrën e Grave", ose "Asociacioni i Grave për të Drejta të Njeriut".

Erëmirë Krasniqi: Qysh e prezentojshin vetën e tyne kur dilshin?

Valdete Idrizi: Jo, *Kosovska Mitrovica* normal, a din kështu, a din prej vet Serbisë. Me vet faktin që ish revolucionari në Serbi, ata thojshin prej Serbisë po thojshin *Kosovska Mitrovica*, tani thojshin “*Mitrovica Rock School*” [Shkolla e Rockut në Mitrovicë]. Megjithatë osht’, a din, si, e përmenshin. Disa edhe s’e përmenshin. Na e shihshim domethonë që veç kanë ecë tutje. Po, janë disa, do përshtypje t’tyne që i shkrujshin vet. Domethonë, qysh jau kanë ndrru edhe jetën domethonë, vet shkumja n’shkollë të, n’shkollë verore në Shkup. Tani ma vonë ja nisën edhe në Kosovë këtu me bo.

Për shembull, kanë shku, kanë ardhë në “Hotel Pallas” këtu në Mitrovicë edhe serb edhe shqiptar ku për herë t’parë kanë dalë në Jug edhe kanë performu edhe kanë harru ku jonë domethonë t’u... se jonë hi krejt n’tripa t’muzikës. Ose tash në “Hamam Jazz Bar” po, po performojnë.

Erëmirë Krasniqi: Vërtetë?

Valdete Idrizi: Po, janë shku, tani në “Swiss Diamond” që ke njëfarë aktiviteti, kur i kom pa, a di sa t’mirë. Edhe...

Erëmirë Krasniqi: Domethonë ju keni punu me integru edhe serbët...

Valdete Idrizi: Po...

Erëmirë Krasniqi: ... n’pjesë tjera të Kosovës...

Valdete Idrizi: Po...

Erëmirë Krasniqi:... jo veç m’i integru në Mitrovicë?

Valdete Idrizi: Absolutisht...

Erëmirë Krasniqi: Vet, domethonë...

Valdete Idrizi: ... jo, jo. E dishëm që për me ta liru dikush prej Jugut, prej Veriut atje banesën, ajo duhet m’i ju bo edhe asaj mundësia mu kthy n’ven të vet, a din, qaty osht’ e mundur, a din, se ndryshe nuk, nuk bohej. Mirëpo, këta jonë, osht’ kur t’i sheh, kanihere une nuk i di, po do kanë studju jashtë, do jonë... Për shembull, e di që Elbenita Kajtazi, ajo osht’, ajo osht’ talente vet, ka punu shumë. Mirëpo, jom shumë krenare sot, si studente ose nxanëse e edhe “Rock Shkollës” ka arritë tash me opera, në “Deutsche Oper Berlin” edhe gjithandej n’botë.

Ose i kena do tjerë, Blerta ose Visar Kasa, ose, do që bejagi jonë t’mirë a din, ose mësimdhansat që jonë jashtëzakonisht t’mirë që kanë kontribu edhe n’zhvillimin e tyne prej... domethonë prej Zanës, Edonit, Nesimit, domethonë që kanë kontribu edhe hala po kontribojnë n’zhvillimin e tyne. Kështu që, une diqysh veç krahtë m’rriten kur t’i shoh, edhe thom edhe atëherë kur krejt kanë menu që une jom pak yhy {bën me shënjë për si e çmendur}, domethonë se s’kanë besu n’qit ide, “Qysh po menon ti për muzikë kur njerzit po vrahën?” Qeshtu m’thojshin. E domethonë qaq ngushtë t’u e kqyr, a din?

Po gjithë kom besu. Edhe tash kur i shoh normal knaqem. Kur t’i shoh vet, rrallë i shoh personalisht, po veç ça lexoj edhe ça dëgjoj kështu prej tyne, qaq sa muj me i përcjellë, diqysh m’bohët zemra mal. Ose, ose “Asociacioni i Grave”, për shembull atëherë me një Qendër t’vogël na shkum masi ka funksionalizu qajo Qendër, nuk osht’... i bojshin do punë dore, tani edhe një, një klasë t’fmive, librat...

Po se ishin serb e shqiptar e s'dishin me fol. Se tash shqiptartë veç sa u kthjeshin, disa veç rrijshin. Mirëpo, kur kish incidente mrena që u rrehshin fmija shqiptar e serb, krejt i zgjedhshin në Qendër gratë.

Fillun tani do drita me instalu aty se kishe s'po din kush, a din, kush kujna p'e sulmon, po gjunë gurë ose n'oborr. A din sa punë t'mira që thjeshtë ndikojshin drejtëpërdrejtë n'përmirësimin e jetës edhe të, edhe t'integrimin tani t'shqiptarve që ishin kthy, edhe t'përmirësimit t'marrdhanjeve, domethonë ndër-shoqërore aty. Shumë punë jonë bo domethonë ajo bash me bisedu jonë bo qaq shumë ma shumë jonë bo. Domethonë, ka pasë efekte t'mira. Tani masi funksionoj jena shku edhe n'lagje tjera t'përzime kur u pa që gratë përnime kanë aftësi që munen me bo ma shumë. U organizun vetë. Edhe ato tani vetë, tasht osht' nji organizatë krejt n'veti.

Janë t'u bo nji punë t'mrekullushme. Kaniherë kur m'thirrin n'aktivitete diqysh knaqem kur i shoh. A din, edhe e di që gjithë ja ka vlejte, edhe thjeshtë me i besu se ato e kanë kry punën, jo une. Une nëse kom qenë veç pak me ja jap naj shtytje. Jom shumë, shumë krenare me, me to. Tonë ajo, ai rrugëtim shumë i vështirë, ajo zbrapsja, ajo ecja, ajo, ajo rrxumja, ajo çumja, domethonë qysh ka shku, gjithë ja ka vlejte. Se nëse e kisha menu që nuk kish me ekzistu tash edhe CBM-i, po edhe organizatat tjera, se na, domethonë çelësi i suksesit është që na kena punu n'partneritet gjithë, përnime ish konë edhe shumë ma keq. A din, nuk kishin me ekzistu këto, edhe këto nisma.

Po diqysh në atë, diqysh pamvarsisht edhe prej përvojës personale edhe përvojave tjerve, përkundër tanë kësaj padrejtësie diqysh jom falenderuse qysh s'e kom hup atë besimin n'njerëzimin. Domethonë, edhe kom arritë m'i dashtë njerëzit, me vazhdu m'i dashtë se nuk u konë e lehtë. Gjithë e ki atë, ato, ato frikat apo ato dilemat si, si gjithkush. Sidomos kur, kur jeton në nji qytet që je gjithë, nihesh pe... diqysh pezull, "Hala s'jom kthy, kom m'u kthy, kom m'u kthy". E ki diqysh, t'bohët pjesë e jetës tone edhe, edhe identitetit tonë diqysh dashtë, s'dashtë. Edhe, në të njejtën kohë privohesh e s'munesh m'u kthy, po gjithë ajo lufta t'u vazhdu. Po...

Erëmirë Krasniqi: E pavarësija a ju dha njifarë shprese juve në Mitrovicë në 2008-tën?

Valdete Idrizi: M'u kthy te Dita e Pavarësisë, për shembull...

Erëmirë Krasniqi: Qysh e keni përjetu ju këtu?

Valdete Idrizi: A din qysh, qat' ditë, për shembull nëse dikush munet me përjetu tona ndjenjat e mundshme n'qatë ditë të Pavarësisë, krejt, krejt t'mundshme. T'u u nisë prej, prej gëzimit ma s'pari, u bo Kosova shtet. T'u u nisë, t'u nisë prej frikës që u bo shtet pa Veriun edhe e ki hup qat' pjesë. T'u u nisë prej frikës qa kanë me ndodhë se e dishëm që qajo pjesa e Veriut qaq rahat nuk e pranon edhe hala ka shqiptar atje edhe kanë me pësu, ose ka me i, edhe njiherë kanë me i dëbu. T'u u nisë domethonë prej asaj që, diqysh u nijsha n'faj që s'mujshëm m'u gëzu plotësisht. A din çfarë ndjenje e keqe që s'mujshe m'u gëzu ti plotësisht për Pavarësinë?

Njejtën kohë ish nji andërr e krejtve që kishim qef me shpalljen e Kosovës, n'tjetrën anë nuk ish e plotë, nuk mujshe m'u gëzu. Për shembull, qat' ditë gjithë ditën jom sill me kerr, sikur, une me shoqen teme edhe kolegen teme, gjithë ditën n'atë turmën e njerzve t'u pa flamura, t'u bërtit e kështu. Edhe, edhe u gzojshe, edhe u tutshe, edhe kështu... edhe tonë kohën n'telefon me ata në Veri. Domethonë, jo veç me kolegë serbë, po edhe shqiptartë që ishin aty, se s'guxojshin m'u gëzu tanësisht. Knena thojshim a osht' normal na mos m'u gëzu bash qikaq shumë qysh po gëzohen ato qytetet tjera.

Shkum në Prishtinë. Atje, a din, krejt tjetër atmosferë. Se këtu domethonë dej te ura s'guxojshe as me ardhë. As me gju qaq shumë me u gëzu. Si, si për çdo ditë çlirimi. Na s'kena as ditë çlirimi këtu me, domethonë me festu. E atje kur shkum, ti diqysh, edhe nijshim nijfarë lloj xhelozije diqysh. Knena u gëzojshe, se normal njerzit duhet m'u gëzu, knena n'faj që s'po munesh plotësisht. E kom kajt si fmija. Edhe qata po e them nuk muj me përshkru ndryshe se krejt, krejt ndjenjat e mundshme atë ditë jonë konë.

Edhe, s'po di. Kthehesh n'shpi edhe n'realitet. A ka ndrru diçka te na? Jo, s'ka ndrru. Prapë edhe t'nesrit mas, mas shpalljes të Pavarsisë prapë s'mujshe m'u kthy n'shpi. Prapë incidente kish. Prapë shpresa ekzistojke. Domethonë, nëse kthehem prapë, domethonë gjithçka çka bojshim, bojshim për njerzit edhe me njerzit. Megjithatë, jeta s'u përmirësu dhe Pavarësija nuk i pruni këto, nuk i përmirësoj as cilësinë e jetës, as.... Kështu që, megjithatë vazhdojke edhe ajo euforia e krejt, e pritjet e krejt, krejt gëzimet që ishin, te na nuk pat' ndryshim. Hiç. Domethonë nuk....

E qikjo osht' ajo friga që patëm qat' ditë t'shpalljes e krejt, që... ka me u bo nashta pa qat' pjesë. Edhe sot, për shembull ani pse shumë është përmirësu raportet ndër-njerëzore, shumë ma pak ka incidente, shumë ma shumë ka qarkullim t'njerëzve që ecin anej, domethonë edhe serb që vijnë knej në Jug, por megjithatë osht' tjetër realitet. Nuk osht', nuk osht' si gjithandej në Kosovë. Megjithate osht' ajo frika si t'dilsh anej mos diçka munet me ndodhë. S'di, ende domethonë osht' ajo, thjeshtë pamundësija jote për m'u kthy n'shpi tone. Aty që ke dashtë gjithë për me u kthy. S'po di. Po, t'njejten kohë na s'kena lluks m'u dorëzu edhe me konë pesimista.

Kështu që, tu e hek, tu e përjashtu at' mundësi që nuk bon na me kon, tani i sheh mundësitë tjera. Çohesh n'kamë edhe i sheh mundësitë tjera edhe i sheh nashta qato dritën, ose dritat që thjeshtë mundet m'u bo ma mirë. Edhe, s'po di nashta që jonë lodhë njerëzit, përnime jonë lodhë se gjatë. Domethonë, i shoh edhe sot kur thojnë, "O a din qysh? As Pavarësija, as Serbia, as Kosova, as kurgjo." Domethonë, krejt këto fjalët e mdhaja ça folën nëpër Bruksel ose andej, nuk ta, nuk ta përmirësojnë cilësinë e jetës. E i kena pa edhe ata serbtë që jonë konë nashta avokursit ma t'mdhej t'ndamjes ose edhe tjetër që jonë konë për me, thjeshtë për me u normalizu e kanë ndrru qasjen se i ka lodhë politika. I kanë lodhë shumë.

E nashta, qikjo osht' edhe shpresa a qajo mundësija që na e shohim. Prej qisaj lodhjes dy anëve, edhe të, të instrumentalizimit t'njerëzve, noshta kjo osht' një mundësi ma e mirë që ka me u bo.... M'u kthy qysh u kthy, kurrë s'ka me u kthy këtu, domethonë jena bind mo. Po, me u kthy noshta nijfarë lloj normalizimi që mos me pasë atë, domethonë gjithë atë frikën e drejtëpërdrejtë, nashta qaty e kam shpresën që munet me u bo, me u kthy.

Erëmirë Krasniqi: A t'flasim pak për çmimet që i ke marrë si aktiviste për paqe?

Valdete Idrizi: Po.

Erëmirë Krasniqi: Qysh ka ardhë deri aty? Çfarë mirënjohje jonë?

Valdete Idrizi: Çmimi parë ndërkombëtar ka qenë në vitin 2008. Faktikisht kam qenë e nominume në fund të 2007-tës. Ka qenë "Gruaja e Guximshme" e ndame prej *State Department* [Departamenti i Shtetit]. Fillimisht bile jom konë në, në Novi Sad jom konë në studime, programi studimeve master ka qenë Master në Menaxhim të Konflikteteve. Edhe më thirri dikush prej Ambasadës të Amerikës, atëherë

Zyra Amerikane. E thotë, “Jom Afërdita, a ke dy minuta kohë?” Thashë, “A bon me m’thirrë ma vonë se jom nxanë?” A din, isha.... Tha, “Po”.

M’thirri. Tha, “Valdete na si zyrë, ekziston një çmim që jepet prej Sekretarit të Shtetit,” tha, “për një grup jo-amerikane. Osh! çmimi ma i madh prestigjioz që ipet për njohjen e kontributit në ndërtim t’paqes, promovimit t’grusë.” Edhe i thashë, “Ok.” S’kisha ndi kurrë t’them sinqerisht për atë çmim. Tha.... Edhe s’kisha pasë naj bashkëpunim une ma herët. As s’kom, s’kisha pasë apliku, s’kom apliku as projekte në Ambasadë, as naj përkr... po menoj s’kom pasë naj bashkëpunim se s’e njifsha. Thotë, “Na kena mendu që, po dojmë me t’nominu për këtë çmim,” tha, “se për punën shumë t’madhe që e bon ti në Mitrovicë me tona komunitetet për ndërtim t’paqes.”

“Uh,” thashë, “faleminderit,” thashë, “shumë mirë”, a din. M’erdh mirë t’them sinqerisht. Tani m’u kujtu se ajo kisha pasë qenë njëherë me një delegacion. Une kom prezantu punën me serb me shqiptar edhe kemi pasë një diskutim po s’e kisha pasë regjistru. Ma vonë m’tregoi. Edhe une harrova qat’ ditë edhe ju thashë, “Mhm... ” atyne kolegëve se ishim krejt prej Ballkanit edhe të Lindjes Mesme. Thashë, “M’thirrën qishtu, po me qito u kry,” thashë, “boll osht’, hej.” Edhe i thashë, thashë, “Faleminderit”, more sa gruaja o në Kosovë. Unë e kisha listën tem që m’inspirojshin mu. Super. Kom harru krejt, s’e kom regjistru.

Mas nja dy mujve... n’fakt kur erdh tha, “Po ka qef me t’taku kjo, zyrtari”, amerikani që ish për marrëdhaje me publikun. Okej, shkova. Hera parë unë me hi në Ambasadë. U takova, fola me to. N’rregull. Edhe tani, e harrova komplet atë muhabet. Kur masnej m’thirrën që jom, ma dhanë informatën që jom n’listë t’shkurtë prej tri vetave. Se krejt Ambasadat nëpër Evropë pe nominojshin ka ni. Ish nifar gare aty. Po s’kom ditë edhe s’kisha kohë se kena pasë qat’here shumë punë, a din, edhe s’i kisha metë une te çmimet. E masnej, përnime menova me qaq u kry edhe boll ke njifarë... u niva shumë krenare, a din.

Kur u ktheva ma kumtunë lajmin, Ambasadorja direkt. Pak m’mashtun me ni trik se tha, “Po donë me fol dikush për projekte me ty.” Edhe kështu m’tanë, “Je fituse. A munesh me shku në Amerikë me marrë çmimin?” Uau, ke shumë, ke, s’po di, shumë përgjegjësi e pata, a din, e përjetova si përgjegjësi shumë t’madhe. Inkurajim gjithsesi për punën që e kom bo dej qatëherë edhe t’njejtën kohë thjeshtë, normal kesh e lumtun, a din. Se hiç s’ma rrokke tani jom konë njona prej tetë grave n’botë që merr një çmim t’tillë për qat’. Diqysh ke... normal që krejt shpija jem u gzunë, domethonë jetojsha me nanën, me vllaun, me nusen e tij.

Edhe u gëzum krejt familja. Se tha, “Mos e bo t’madhe, veç me familje me miq.” Këtu u hallakatën stafi, u gëzun krejt. Se ajo që m’ka gëzu tej mase o se nuk e kanë përjetu veç si çmim tem, po si çmim t’vetin. Domethonë, krejt me cilët punojsha, se qajo isha une. Une s’isha veç ni Valdete. Une tash për shkak meje, po unë isha krejt qata bashkë. E qajo m’ka gëzu se qashtu diqysh kanë, e kanë pranë edhe këtë çmim. E tani normal me shku në Amerikë, atje me pranë edhe krejt ndjenjat, edhe aty ndjenjat e mundshme... m’u kujtojke baba jem për shembull që para një kohe kur isha e vogël thojke, e kqyrshim një shpi, po menoj Shtëpinë e Bardhë faktikisht në një film, e gjithë thojke, “Kjo a? Kjo qatje ka me m’shku.”

A din, e m’u kujtojke ajo, komplet ajo. E normal kjo ka qenë me u, me u kthy tash te puna, m’ka ndihmu shumë sepse u bo një bujë e madhe, një famë shumë e madhe, sepse ish menihere mas shpalljes së Pavarësisë, ish, domethonë ish një çmim për paqe me ju jep një grusë domethonë. Edhe si e

Evropës isha e para që e kisha marrë a p'e din, ma herët s'e di kush e kish e ka pasë fitu një çmim të tillë, po. A pi Ballkanit hiç se hiç, a di. Edhe bukur u dha shumë mirë n'media. Qatëherë tani fillun liderat tonë edhe me m'pranu n'takime edhe me ma uru, edhe në njëfarë forme me njëoft edhe punën teme.

E qikjo ka qenë menoj nashta suksesi ma i madh se mu m'ka nimu masnej me, edhe ma lehtë domethonë m'i realizu disa prej projekteve. Do pengesa që janë konë shumë t'mdhaja, ose do sulme që i kisha shumë t'mdhaja diqysh u, pak u minimizunë se, "Ha këto tash e ka njëoft Amerika". Plus isha musafire nderi e Presidentit të Amerikës atëherë, a din, n'qatë kohë edhe ka qenë privilegj i madh. Kjo, gjithë puna, tonë këto vjet, gjithë ai rrugëtim që përmenda ma herët, a din, u njëoft pi diku. Edhe thojsha qysh po m'thotë mu njeri ma i fuqishëm n'botë, "Falemnerës që po kontribon n'paqe në botë", kur unë e kom obligim. A po kupton?

Kjo osht' punë që unë e konsideroj obligim me punu për ven tem. Diqysh m'ka, s'po di, normal që m'ka, m'ka bo m'u ndi shumë krenare me krejt ato njerëzit përrreth meje. Tani mas këtij kanë pasë pasu edhe disa çmime tjera. Në një vit më, një vit tjetër, 2009-shi, osht' një, osht' *Soroptimist Peace Prize* që osht' jep prej grupit Soroptimist, kjo Federata Evropiane. Edhe ka pasë ardhë bre n'momentin ma t'mirë të mundshëm, sepse me atë çmim, përveç njohjes domethonë edhe njëhere, sepse ish, ish Kongresi që u majt në Amsterdam ku e kisha fjalën kryesore atje... sidomos mas shpalljes Pavarësisë edhe ça e pritshin venin tonë edhe domethonë progreseve t'arrituna me krejt...

Edhe kisha një mundësi domethonë punën time me prezantu para krejt, domethonë 1000 gra aty ishin në sallë prej krejt veneve t'botës. Se mu m'kishin nominu "Klubi Soroptimist i Prishtinës". M'kanë njëoftë përmes domethonë edhe çmimit parë edhe punës që e kom bo, edhe shumë intervista edhe thjeshtë kanë besu që jom e denjë me fitu atë çmim. Kur kom shku atje, me çmim ka ardhë edhe një shpërblim prej 20 mijë euro. E me tregu pse po thom n'momentin ma t'mirë t'mundshëm se qatëhere u bo "Rock Shkolla" edhe kishim edhe krizë financiare për me ekzist, për me hup lokacionin, "Qendra e Grave", ne na u kthyn nja dy përgjigje negative. E kështu.

A din kur kanë ardhë ato pare bre tamam mi çu n'komë ato. Se menihere ju kom thonë, jo e llogarita mos m'i çu, po drejt organizatës se domethonë ja rahat, i gjetëm venin. Që n'qatë kohë, domethonë ma vonë me konë ardhë dhjetë-fish ma shumë pare, s'kishin pasë efektin e njëjtë. Kështu që, nashta keq o me menu punën e pareve po ajo ka qenë befasi shumë e mirë se kanë shku bash qaty edhe për çka osht' marrë çmimi. Se s'osht', jo si unë Valdete, po qata t'ri, qato gra, gjithë ajo punë që e kanë bo. Edhe kur ju kom thonë tani a din që thashë n'kohën ma t'mirë t'mundshme m'ka ardhë.

Ky, edhe ky shpërblim, domethonë mas asej statusë, edhe kom, përnime ka qenë privilegj shumë, shumë i madh. Edhe jom falenderuse edhe prej atyne që m'kanë nominu shumë sepse përnime menoj që ka shumë gra që kanë meritë çmimin edhe që kanë bo ma shumë se une, edhe gjeneratat ma përpara meje edhe kështu. Edhe jom ndi shumë, shumë krenare. Për qata e kom shumë përgjegjësi se, a din, hej sa gratë e kishin meritë, unë e kom marrë tash duhet me majt. Duhet me punu, duhet me punu edhe ma shumë.

Tani edhe s'fundmi, n'vitin 2016 ish edhe një çmim tjetër. Ajo, bile ky ka ardhë shumë, shumë befasi e madhe, "*Women International for Television and Showcase Prize*" [Çmim ndërkombëtar për gratë në televizion], qashtu quhet "*WIFTS Peace Prize 2016*". As për to s'kisha dni, bile me televizion thojsha ça kom lidhje une, a din? Po ishte Arta Dobrosi m'thirri, ajo aktorja që përnime e du shumë. Unë menova që p'i vyj për naj material diçka, dokumentar, a naj film a. Domethonë, ça muj me bo për ty, se

e du shumë thashë hajt. U takum. Thotë, “Çka je tu bo?” Okej, thashë, “Po punoj në CiviKos, p’e udhëheqi. Jena t’u rritë,” thashë, “si organizatë. Jonë do suksese t’mira që jonë t’u u bo. Do probleme, do sfida”.

Thashë, “Gjysma jeme,” thashë, “po punon” thashë. Isha mentore e vajzave për paqe, serbe dhe shqiptare. Thashë, “Kjo ana tjetër e jemja”. Sa e kishim nisë Akademinë e Grave të Dialogut për vajza t’reja. Edhe thashë, “Jom hala në Forumin e Mitrovicës t’u e udhëheqë.” Thashë, “Këto jonë ato vullnetare, gjysa jeme.” Thashë, “Gjysa me CiviKos.” E tha, “U sa mirë”, tha kështu. Kur masnej po thotë, tha, “A di, a din ça osht’ një çmim”, kështu, kështu, kështu”. Une tash po kujtoj që ajo. Une, “Uau” thashë, “sa mirë.” Une po kujtoj që po thoë për veti ajo. U gëzova.

Kur tha, “Jo,” tha, “ti” tha. Thashë, “Pse une?” Kur thashë [tha ajo], “Qysh pse, ça m’kallxove ça je t’u bo veç qitash?” Thashë, “Jo more, po ajo osht’ për film.” Edhe ke shumë, shumë, s’po di me ta...

Erëmira Krasniqi: Ajo t’nominoj, a ta kumtoj lajmin?

Valdete Idrizi: Jo, ma kumtoj lajmin. Po ajo m’tha, m’tha që, “Une nuk kom,” tha, “dorë n’këtë punë. Une jom veç njo prej njerëzve që kur m’kanë pytë për ty,” tha, “ju kom dhonë edhe informata.” Normal që ajo ka shtu, osht’ gëzu edhe ka jep domethonë edhe informata. Ka qenë edhe nashta prej “fajtoreve”. Po edhe dikush tjetër, ka qenë njifarë, një producent që ka pasë qenë këtu në “*Bridge Film Fest*” [Festivali i Filmit të Urës] për shembull, që ka nejt një javë këtu. Kemi fol për punë, e ja kom tregu situatën. Edhe ai tani kish qenë qai personi i dytë. Ku e disha une që... as s’kisha pasë ndi as për këtë organizatë hiç.

Edhe, kështu që vjet domethonë në, në Londër shkova, atje dhe e pranova. Sidomos me qenë n’mesin e grave që i kisha pa n’televizor për shembull, a din, n’filma... aktoreve t’njoftuna, producente, regjisore. Diqysh, une m’u dni aty, thojsha, “Huh”. Ke shumë, shumë, shumë e mirë. Po nashta edhe mirënjohja, mirënjohjet tjera që i kom prej, prej komunitetit e pi njerëzve, edhe ato jonë që kanë qenë shumë, shumë, shumë që i ruj diqysh me, me, me fanatizëm. Këto m’bojnë po m’duket me u bo person ma i mirë edhe punëtore ma e madhe. Se për shembull edhe vjet në Cerajë, n’fshatin tem ma kanë bo një befasi.

Ma dhanë një mirënjohje për, thjeshtë, punën që e kom bo. Edhe, përnime unë jom e re për me marrë mirënjohje, a din, prej, a din... duhet me marrë dikush, konsideroj dikush ma i vjetër, dikush që për një bagazh jetësor edhe profesional duhet.... E, m’kanë, m’kanë bo me kajt shumë se unë, s’kem jetu kurrë atje. Kemi, kemi shku sa herë kemi dashtë. Kemi lexu shumë edhe për librat që kanë shkru për Cerajën. Edhe po, ishin mledhë krejt bashkë. Tani t’rijtë e Mitrovicës, e shoqërisë civile... kom nda do.... Kështu që, jom shumë, shumë... kom fat une.

Edhe njikohësisht jom shumë, shumë falenderuse për krejt. M’kanë bo, thjeshtë, edhe punën me bo ma mirë sepse i kom marrë si shumë përgjegjësi t’madhe. Përveç domethonë, diqysh noshta edhe krenarisë edhe thjeshtë kom dashtë përmes qasaj fame me dhonë një mesazh që, që Valdete gjithsecili, ose gjithsecila jena. Edhe qaq sa kom mujt e kom shfrytëzu domethonë për me jep mesazhin që përnime me dashtë njeri, edhe besimi, këmbëngulja, dashnija mes, a din, për njerëzit edhe për venin tond nuk osht’ shumë e thjeshtë, veç duhet mos m’u dorëzu.

Erëmira Krasniqi: Na qitu munem me kry intervistën, po jom tu dashtë m’u siguru që ka mbetë, nëse kishe dashtë edhe diçka tjetër me na tregu që... po mendoj që osht’ e domosdoshme m’u thanë? Po s’ki nevoje, a din? Krejt senet që na ke kallxu jonë kanë shumë interesante.

Valdete Idrizi: Mos...

Erëmira Krasniqi: Veç ma shumë keni tregime për njerëz se nëse keni anashkalu diçka, ky osht’ momenti ku kishim mujt m’u kthy n’diçka pak ma specifike? Po mendoj me na fol për iniciativën për qytetet e ndame...

Valdete Idrizi: Po.

Erëmira Krasniqi: A osht’ diçka që osht’...

Valdete Idrizi: Osht’ shumë e randësishme edhe qajo sidomos te, po osht’ e randësishme. E disha se qata, a din që thashë ma herët po kom qef me fol. Sidomos osht’... Për shembull, ideja e “Forumit të Qyteteve në Tranzicion”. Në 2008-shin u takova profesor, osht’ Borego Mali, edhe ish një person që kish jetu n’vene, n’qytete t’ndame prej... gjatë aparteidit në Afrikën e Jugut, e Bostonit. Ai ish faktikisht me origjinë prej atje. Na në Irlandë të Veriut edhe po tregon si ide edhe diqysh m’u hapën sytë. Thashë, tha, “Nashta edhe Mitrovica kish qenë” tha, “po kena problem Mitrovicën sepse janë komunat Jug – Veri që nuk e njohin njoni-tjetrin pavarësisht shpalljes Pavarësisë edhe krejt.

Komuna Jug-Veri nuk e, nuk e, domethonë nuk e njofshin njona-tjetrin. Këta thojshin, “Komuna ilegale”, ata thojshin, “Komuna e Serbisë”, domethonë me Veri, domethonë ilegal faktikisht njoni-tjetrin. Po t’u qenë si dikush që osht’ i njoftun edhe aktiv edhe i pranushëm pi dy anëve edhe thashë, “Une jom n’pozicion goxha t’mirë me mujt m’i bind edhe këta pjesë e Veriut e Jugut e me qenë pjesë e ‘Forumit të Qyteteve në Tranzicion’”. Se ajo ish njëfarë kushti se Komuna duhet me qenë, domethonë nëse ‘Komunat’ në rast, në rastin tonë.

Edhe diqysh menjherë i thashë, “Po”. Thashë, “*Yes, we can do it*” [Po, mund ta bëjmë]. Hiç pa e menu këto qysh kom m’i bind, tek kom m’i bind. Po edhe e pashë diqysh që na si qytet edhe diqysh e pashë përfitimin. Se mënyra kur m’kallxoj disa qytete, t’u e pa edhe Berlinin, noshta, domethonë se kanë qenë t’ndame edhe jonë bo bashkë. Ose Irlanda e Veriut, a din, qysh ka shku procesi i paqes, a din, kisha lexu goxha shumë une edhe gjatë studimeve po edhe kështu më interesojke. Edhe kur erdha në Mitrovicë ma s’pari te Kryetari në Jug thashë, “Kështu, kështu osht’ ni ide”. Ja bojsha edhe ma t’madhe kështu. N’fakt ish, po edhe ma shumë se që.... Kisha marrë informatat e para.

Njejtë, po provoj me shku atje në, në Veri, po përmes kolegëve nihere p’i ja gjej gjithë planin, domethonë diken. I gjeta domethonë, se qysh ishin atje dikush prej mediave, dikush shoqnisë civile, dikush prej biznesit edhe bashkarisht. Edhe mrrijtëm, domethonë, mrrijtëm me u bo si delegacion. Në 2009-shin jemi shku në Boston, në Universitet Massachusetts, edhe aty u themelu “Forumit të Shteteve në Tranzicion” e parameno Mitrovica si qytet founding city, qytet që, themelus i qatij. Edhe masi ishin domethonë dy Kryetarët, dy përfaqësuesit e Komunës, zyrtarë, plus edhe nivelit qendror patëm si Ministër, ish Bajram Rexhepi, Sadri Ferati, Oliver Ivanovići, Ljubiša Pertović, ishin krejt këta t’politikës edhe na tjetrtë të shoqnisë civile.

Në mënyrë që mos me, mos me pasë noshta një problem ndërmjet veti çfarë narrativi p’e qesim përpara, na besun neve, t’shoqnisë civile. Edhe ke vendim i mirë sepse kur e prezantum, edhe qaç

shumë kem entuziastë, bile pa e pasë pëlqimin e krejtve dulëm edhe tham, “Na po bohëm qyteti i parë vullnetar me organizu konferecën inauguruse të qyteteve në tranzicion në 2010-shin”. Oh, as që na bike n’men ça do me thonë ajo, po menoj sa punën sa përgjegjësini edhe n’çfarë kohe menojsim. Domethonë, 2010-tën në maj u mjashin zgjedhjet lokale të Serbisë që u majshin në Mitrovicë të Veriut edhe e dishëm që jonë. Edhe kur jonë zgjedhjet gjithë ka telashe.

I pritshëm afër njiqind delegacione prej krejt botës edhe u deshke me u, me ju nimu domethonë a viza, dokumente kështu. U deshke me përgatit krejt programin m’u siguru që krejt osht’ në rregull. Për ma tepër në Qendrën e Kulturës ku ish ma e përshtatshme me ardhë edhe Jugu edhe Veriu as s’punojsin domethonë kanalizimi, ato tualetet poshtë edhe krejt llom. Kur kemi thonë, “Po”. Atëherë, s’e kena menu bash qito probleme. Po, tani, kadal kadale u ulshëm, shkrujshëm, e i kallxojsim domethonë sekretariatit që ish atje në Boston, “I kena qito probleme. Duhet, fol me donatorë të ndryshëm”, besomni i sigurum dikun 350 mijë euro.

Edhe, se na si Forum jena, osht’ ekip vullnetar, nuk osht’ i regjistru si organizatë. I kena nënshkru do, disa parime domethonë mbi t’cilat na funksionojmë, thjeshtë me, mos me qujt a Kosovo Metohija a Serbi a kështu, po me u fokusu te qyteti edhe te qytetarët. Shumë vështirë u konë me ardhë deri te qato po kena mrrri. Edhe, a din që konferenca ka pasë me ardhë, domethonë ka pasë me u nisë t’nesërmen, domethonë qat’ datë, na domethonë hala dyshemeja nuk u pasë terë mirë qaq që u rregullu, u pastru. Domethonë gjithë natën edhe dita ditë përpara osht’ rregullu.

Edhe, ka qenë njo prej konferecave ma t’mira najherë që kanë mujt me ndodhë. Kur them ma t’mira edhe me përfaqësim sepse dy prej liderëve serb jonë konë n’panel edhe që jonë konë n’garë për Veri, n’zgjedhje domethonë. Kena pasë për herë t’parë policitë, komandantat e dy stacioneve t’policisë, për herë t’parë që jonë ballafaqu drejtëpërdrejtë me nji panel, se kurrë s’i ke pasë përpara. E ki pasë në nji panel njerëz që s’e njoftin njoni-tjetrin edhe që njerëzit në hyrje, se krejt jonë videot këto që jonë në, në atë webfaqen e....

Edhe kemi mrrri me i pasë delegacionet e shumë veneve t’ndame, prej domethonë prej Kirkikut të Irakut, prej dy qyteteve në Irlandë të Veriut, Belfast edhe Derry, London Derry se me dy qytete n’varësisht prej cilës anë osht’. I patëm Nikozinë të Qipros, Mostarit. Ma vonë edhe të Berlinit, të Nigerisë që jonë Kaduna. Domethonë t’krejt veneve të ndryshme i patëm, të Bejrutit, i kishim të Jerusalemit edhe Haifës, domethonë si qytete. Ma vonë jonë ardhë edhe të Ramallahut. Kështu që, krejt qytetet që ose janë t’ndame ose që i qujmë qytete në tranzicion, ose kanë qenë t’ndame tash jonë në nji fazë tjetër.

Po pse po e përmeni osht’ shumë e randësishme sepse në njëerën anë duke qenë ti si shoqëri civile domethonë kjo ka qenë mënyra e vetme për me mujt me hecë sepse ti je njoft prej dy, dy anëve t’qytetit që s’e kanë njoft njoni-tjetrin. E dyta, kena përfitu shumë si qytet prej programeve tjera që kanë pasu. Për shembull, policia Jug edhe Veri kanë shku disa herë në Irlandë të Veriut, edhe programe, trajnime që nuk i kanë në kurrikulë këtu. Domethonë, qysh me reagu në rastin e paradave kur organizohen, se te na s’ka pasë e atje jonë bukur t’njoftuna. I kanë shkëmby përvojat.

Ka pasë, ka pasë njikohësisht vizita nëpër, në Izrael që kanë shku në vene të ndryshme domethonë t’rijtë e Mitrovicës, vullnetartë. Kemi mrrri me zhvillu domethonë projekte tjera, qeto renovimin e sallës për me u realizu konferenca. Edhe sot vazhdon ai, domethonë ai Forum ku secili qytet i merr do ‘detyra t’shpisë’, do obligime që kontribojnë në bashkim t’qytetit, apo domethonë përmirësimin e qytetit. Kështu që, edhe kjo ka qenë nji, duke qenë pjesë e botës, kushtimisht po thom si qytet, edhe e

shih që kadale, noshta duhet kohë deri sa të realizohet qyteti po nuk osht' e pamundun. Veç ta ka jep domethonë edhe një, një dritë shprese që mundet me u bo ma shumë.

Tjetrën anë kemi mri thjeshtë këto kryetarët domethonë me, thjeshtë me u bo bashkë, edhe kush që s'e njihshin njoni-tjetrin. Kështu që, domethonë ka qenë, e kena shfrytëzu goxha mirë n'mënyrë që me përfitu si qytet, a din, jo individualisht.

Erëmira Krasniqi: A vazhdon me qenë bashkëpunimi i afërt?

Valdete Idrizi: Po, bashkëpunon, ani pse sa i përket bashkëpunimit t'komunave osht' zbehë këto, këto dy vitet e fundit sidomos, sepse ka pasë pak a shumë një neglizhencë prej, domethonë prej komunave. Mirëpo, megjithate si delegacion kemi mri me shku, si shoqni civile, me u zotu për shembull në, në Liban që janë një prej qyteteve tash që i kanë, janë nikoqir, i kanë, dhe në një proces që duhet me ju ndihmu. Na jemi zotu për shembull në, në projektet në fuqizimin e grave, disa nga praktikat që i kena pasë këtu, domethonë me shku me ju ndihmu atyre. qQaq kemi mujt se prej Komunës masi s'kemi pasë, këtë here, gadishmëri.

Po ka pasë kur thojnë edhe tenalte edhe teposhtëze, kështu që po shpresoj që ka me, vitin tjetër thjeshtë ka me qenë Mitrovica qysh ka qenë në nivelin domethonë ma t'mirë edhe ma t'madh domethonë edhe t'dhënies t'kapaciteteve edhe t'marrjes domethonë t'thithjes edhe t'fondeve, pse jo. Per t'mirë të qytetarëve, komuniteteve. Kështu që, ka qenë njo prej përvojave najherë ma t'mira. Se mrijtëm tani me qenë nikoqir në 2013-shin i qyteteve, Forumi i te Rinjëve i Qyteteve në Tranzicion, se kenë t'rijtë e Mitrovicës që fitun edhe bursa me shku, me shku në Amerikë me studju.

Tregun, njo e Veriut njo e Jugut, domethonë tregun që na kemi cilësi shumë t'mira, një përkushtim, studentë t'mirë. Tani u tregun taman si liderë t'rive, t'cilët entuziastë si na që ishim ma t'vjetër, thanë që munden me bo këtu Forumin e të Rinjëve. Edhe rezultoi t'jetë edhe një Forum i suksesshëm me delegacione tani veç t'rive që erdhën tani në Mitrovicë, ku na që ishim pak ma t'vjetër tani veç e ndajshim përvojën me ta edhe u munojshëm me inkuraju.

Kështu që, po vazhdon edhe jam shumë e sigurtë që do t'vazhdojë edhe, edhe në t'ëardhmen sepse nuk kanë me mujt domethonë me e ndalë një individ apo një Krytar, apo një Kryetare, nuk kanë me mujt me ndalë. Po, nganjihere ka raste kur ngadalësohet. Kena pa edhe komuna tjera që s'kemi pa gadishmërinë e një individ po presioni që kanë bo ndaj individëve tjerë kanë mri me, me ecë tutje. Une kom me vazhdu domethonë me punu vullnetare edhe n'këtë Forum edhe me, me, me thjeshtë me bo presion që me i kry edhe na qato detyra të shpisë t'cilat na takojnë, se edhe me përfitu edhe prej përvojave tjerve, që me u bo nashta si Berlini qysh u konë përpara edhe na me u bo.

Se osht' inkurajuse kur i shihshim njerëzit pej Berlini me pa, "Uuu". Ose, Irlandën e Veriut n'atë urën e Dairyt për shembull kur ecshim kur tregojshin, ose n'filma i kom pa, kur tregojshin që u konë e pakalushme hiç, sikur kjo e jona. E tash, kalojshim na, ecshim atje. Qikjo osht' e... po, Forumi e du shumë këtë nismë se ja kena pa hajrin shumë.

Erëmirë Krasniqi: Po e përfundojmë qitu.

Valdete Idrizi: Okej.

Erëmirë Krasniqi: Shumë falemnderit

Valdete Idrizi: Falemnderit juve se s'kom kallxu histori n'jetë tem kaq shumë kurrë (qeshin gjitha). Edhe sidomos nashta për herën, për pjesën e parë, kurrë s'kisha besu që kisha mujt m'i nxjerrë krejt qato, se s'kom menu, a din, hiç s'kom menu, po...

Erëmirë Krasniqi: S'ke pasë kur...

Valdete Idrizi: Jo, bash. Po jom e, jom e lumtur me.... *Thank you* [Falemnderit].

Erëmirë Krasniqi: Falemnderit.

